

URDHËR
Nr. 170, datë 13.9.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE
PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE QË LIDHEN ME AERODROMET NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të pikës 10, të nenit 54, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri i ministrit përgjegjës për transportin nr. 122, datë 12.3.2019, “Për miratimin e rregullore ‘Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë’”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

RREGULLORE
**PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE QË
LIDHEN ME AERODROMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Kjo rregullore përfshin kërkesat dhe procedurat administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 13.3.2015.

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton rregulla të hollësishme për:

a) kushtet për përcaktimin dhe njoftimin tek aplikanti për bazat e certifikimit të zbatueshme për një aerodrom siç parashikohet në anekset II dhe III;

b) kushtet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, kufizimin, pezullimin ose heqjen e certifikatave të aerodromeve dhe certifikatave për organizatat përgjegjëse për operimin e aerodromeve, duke përfshirë kufizimet operative që lidhen me projektimin specifik të aerodromit, të përcaktuara anekset II dhe III;

¹ Ky urdhër përafron plotësisht Rregulloren e Komisionit Evropian nr. 139/2014 e datës 12 shkurt 2014 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet në pajtim me Rregulloren (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e ndryshuar me Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 2018/401, Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2020/469 dhe Rregulloret e Deleguara të Komisionit (BE) nr. 2020/1234, nr. 2020/2148 dhe nr. 2022/208, botuar në Fletoret Zyrtare të BE-së; L44, datë 14.2.2014; L72, datë 15.3.2018; L104, datë 3.4.2020; L282, datë 31.8.2020; L428, datë 18.12.2020 dhe L35, datë 17.2.2022.

c) kushtet për operimin e një aerodromi në përputhje me kërkesat themelore të përcaktuara në shtojcën VII dhe, nëse është e zbatueshme, në përputhje me shtojcën VIII të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, siç përcaktohet në aneksin IV;

d) përgjegjësitë e mbajtësve të certifikatave siç përcaktohet në aneksin III;

e) kushtet për pranimin dhe konvertimin e certifikatave ekzistuese të aerodromit të lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore;

f) kushtet për vendimin mbi përjashtimet e përmendura në nenin 2, pika 7 të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, duke përfshirë këtu kriteret për aerodromet e mallrave, njoftimin e aerodromeve të përjashtuara, si dhe rishikimin e përjashtimeve të dhëna;

g) kushtet sipas të cilave operimet do të ndalohen, kufizohen ose do të jenë subjekt i disa kushteve në interes të sigurisë në operim (*safety*) të përcaktuara në aneksin III;

h) kushtet dhe procedurat për deklarimin nga dhe për mbikëqyrjen e organizatave përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit referuar në nenin 372. të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, siç përcaktohet në anekset II dhe III.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil i përfshirë në certifikimin dhe mbikëqyrjen e aerodromeve, e operatorëve të aerodromit dhe ofruesve të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në aneksin II.

3. Operatorët e aerodromit dhe organizatat përgjegjëse për sigurimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në anekset III dhe IV.

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje:

1. **“Aerodrom”** nënkupton një zonë të caktuar (duke përfshirë çdo ndërtesë, instalime dhe pajisje) në tokë ose mbi ujë, ose mbi ndonjë strukturë fikse në tokë, fikse në det apo strukturë lundruese që do të përdoret tërësisht apo pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen e avionëve mbi sipërfaqe.

2. **“Aeroplan”** nënkupton një avion të drejtuar nëpërmjet energjisë, më i rëndë se ajri, i cili e përfton ngritjen në fluturim kryesisht nga reaksionet aerodinamike në sipërfaqet të cilat mbeten fikse në kushte të caktuara të fluturimit;

3. **“Audit”** nënkupton një proces sistematik, të pavarur dhe të dokumentuar për marrjen e të dhënave (provave) dhe vlerësimin e tyre në mënyrë objektive për të përcaktuar shkallën në të cilën janë përmbushur kërkesat;

4. **“Autoriteti kompetent”** nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar, më poshtë referuar Autoriteti i Aviacionit Civil, me kompetencat dhe përgjegjësitë e nevojshme për certifikimin dhe mbikëqyrjen e aerodromeve, si dhe personelin dhe organizatat e përfshira në to;

5. **“Avion”** nënkupton një mjet, i cili mund të qëndrojë në atmosferë nga kundërveprimi i ajrit, përveç kundërverpimit të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës;

6. **“Dokumenti i Pranimit të Devijimit dhe Veprimit”** (DPDV) nënkupton një dokument të hartuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për përpilimin e elementeve provues (dëshmisë) së paraqitur për të justifikuar pranimin e devijimeve nga specifikimet e certifikimit të miratuara me rregullore të Autoritetit të Aviacionit Civil;

7. **“Inspektim”** nënkupton një vlerësim të pavarur nëpërmjet vëzhgimeve dhe gjykimeve të shoqëruara sipas rastit nga matje, eksperimentime ose vlerësime, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat e zbatueshme;

8. **“Lëvizje”** nënkupton ngritjen ose uljen e avionit.

9. **“Mbikëqyrja e vazhdueshme”** nënkupton detyrat të cilat ushtrohen për zbatimin e programit të mbikëqyrjes në çdo kohë nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil për të verifikuar se kushtet sipas të cilave është dhënë një certifikate vazhdojnë të plotësohen gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj;

10. **“Pengesë”** nënkupton të gjithë objektet e palëvizshëm ose të lëvizshëm (qoftë të përkohshëm apo të përhershëm) ose pjesë të tyre, të cilët:

- janë të vendosur në një zonë të destinuar për lëvizjen në tokë të avionit; ose
- shtrihen mbi një sipërfaqe të caktuar për mbrojtjen e avionit në fluturim; ose
- qëndrojnë jashtë këtyre sipërfaqeve të përcaktuara dhe që janë vlerësuar si një rrezik për lundrimin ajror;

11. **“Shërbimi i menaxhimit të vendqëndrimit të avionit”** nënkupton një shërbim të ofruar për menaxhimin e aktiviteteve, lëvizjen e avionëve dhe automjeteve në një vendqëndrim të avionit;

12. **“Specifikimet e certifikimit”** nënkupton standardet teknike të hartuara nga Agjencia dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil në cilësinë e një autoriteti mbikëqyrës kombëtar, të cilat përcaktojnë mjetet për të treguar përputhshmërinë me udhëzimin nr. 3 datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 13.3.2015 dhe me rregullat zbatuese të tij, standarde të cilat mund të përdoren nga një organizatë për qëllime certifikimi;

13. **“Sipërfaqe e kufizuar e pengesave”** nënkupton një sipërfaqe që përcakton kufijtë në të cilat objektet mund të projektohen në hapësirën ajrore;

14. **“Sipërfaqe e mbrojtur nga pengesa”** nënkupton një sipërfaqe e përcaktuar për sistemin e treguesit vizual të këndit të afrimit mbi të cilën nuk do të lejohen objekte ose shtrirje të objekteve ekzistuese përveçse kur, sipas mendimit të autoritetit përkatës, objekti i ri ose shtrirja e tij do të jenë të mbrojtura nga një objekt ekzistues i palëvizshëm.

15. **“Vendqëndrimi i avionit”** nënkupton një zonë të caktuar për të akomoduar avionët për qëllim të hipjes dhe zbritjes së pasagjerëve, ngarkimit dhe shkarkimit të postës, mallrave, karburantit, si dhe për qëllime të parkimit apo mirëmbajtjes.

Neni 3 Mbikëqyrja

1. Autoriteti i Aviacionit Civil është Autoriteti Kompetent, me kompetencat dhe përgjegjësitë e nevojshme për certifikimin dhe mbikëqyrjen e aerodromeve dhe operatorëve të aerodromit, duke marrë deklarata dhe mbikëqyrje të ofruesve të shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit, si dhe të personelit të përfshirë në të.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil është i pavarur nga operatorët e aerodromit dhe ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit. Autoriteti i Aviacionit Civil ushtron kompetencat e tij në mënyrë të paanshme dhe transparente.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të ketë kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tij sipas kësaj rregulloreje.

4. Personeli i Autoritetit të Aviacionit Civil nuk do të kryejë aktivitete të mbikëqyrjes kur ka fakte se kjo do të çojë direkt apo indirekt në një konflikt interesi, veçanërisht kur lidhen me interesa familjare ose financiare.

5. Personeli i autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për kryerjen e detyrave të certifikimit dhe/ose të mbikëqyrjes duhet të jetë i autorizuar për të kryer, më së paku, detyrat e mëposhtme:

a) të shqyrtojë procesverbalet (regjistrat), të dhënat, procedurat dhe gjithë materialet e tjera që lidhen me kryerjen e certifikimit dhe/ose detyrat e mbikëqyrjes;

b) të marrë me vete kopje ose evidenca nga këto procesverbale (regjistra), të dhëna, procedura dhe materiale të tjera;

c) të kërkojë në vend çdo shpjegim verbal;

d) të hyjë në aerodrome, objektet përkatëse të tyre, zonat e operimit ose zona të tjera përkatëse, si dhe mjetet e transportit;

e) të kryejë auditime, hetime, kontrole, ushtrime(teste), vlerësime dhe inspektime;

f) të ndërmarrë ose të nisë masat detyruese që konsiderohen si të përshtatshme.

6. Detyrat e paragrafit 5 do të kryhen në përputhje me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Informacione për Agjencinë Evropiane për Sigurinë e Aviacionit

Kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të marrë masa për të komunikuar me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (“Agjencinë”) në lidhje me informimin për emrat, vendndodhjet, kodet aeroportuale të ICAO-s së aerodromeve dhe emrat e operatorëve të aerodromit, si dhe numrin e udhëtarëve dhe lëvizjeve të mallrave të aerodromeve për të cilat zbatohen parashikimet e VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Përfshirjet

1. Kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë Agjencinë për vendimin e tij për dhënien e një përfshirje në përputhje me nenin 2, pika 7, të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, brenda një muaji pas vendimit të marrë. Informacioni i përcjellë Agjencisë do të përfshijë listën e aerodromeve në fjalë, emrin e operatorit të aerodromit dhe numrin e lëvizjeve të pasagjerëve dhe mallrave të aerodromit të vitit përkatës.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të shqyrtojë mbi baza vjetore shifrat e trafikut të aerodromit të përfshiruar. Nëse shifrat e trafikut në këtë aerodrom kanë tejkaluar ato të parashikuara në nenin 2, pika 7 të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” gjatë tre viteve të fundit të njëpasnjëshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të informojë Agjencinë kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe dhe do të anulojë përfshirimin.

3. Kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, Komisioni Evropian mund të shprehet që të mos lejojë një përfshirje në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk janë përmbushur objektivat e përgjithshme të sigurisë të rregullores (EU) 2018/1139 të Parlamentit dhe Këshillit, transpozuar me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”;

b) kur shifrat përkatëse të trafikut të pasagjerëve dhe mallrave janë tejkaluar gjatë tre viteve të fundit të njëpasnjëshme;

c) kur përfshirja nuk është në përputhje me ndonjë legjislacion tjetër përkatës, duke konsideruar parashikimet e Marrëveshjes Shumëpalëshe.

4. Kur është e zbatueshme sipas Marrëveshjes Shumëpalëshe dhe kur Komisioni Evropian shprehet që përfshirja nuk është e lejuar Autoriteti i Aviacionit Civil, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes Shumëpalëshe, do të anulojë përfshirimin.

Neni 6

Konvertimi i certifikatave

1. Certifikatat e lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të mbeten të vlefshme deri në afatin që ato janë lëshuar, në përputhje me këtë nen, ose në rast se janë lëshuar pa afat, deri më 31 Dhjetor 2020.

2. Para përfundimit të periudhës së specifikuar në paragrafin 1 të lartpërmendur, Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë certifikatat për aerodromet dhe operatorët e aerodromit në fjalë, në qoftë se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) baza e certifikimit e përmendur në aneksin II të kësaj rregulloreje është vendosur duke përdorur specifikimet e certifikimit të rekomanduara nga Agjencia dhe të pranuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, duke përfshirë këtu raste të mundshme të niveli ekuivalent të sigurisë dhe kushteve të veçanta të cilat janë identifikuar dhe dokumentuar;

b) zotëruesi i certifikatës ka treguar pajtueshmërinë me specifikimet e certifikimit të cilat janë të ndryshme nga kërkesat kombëtare mbi bazën e të cilave është lëshuar certifikata ekzistuese;

c) zotëruesi i certifikatës ka treguar pajtueshmëri me ato kërkesa të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij, të cilat janë të zbatueshme për organizimin dhe operimin e tij dhe që janë të ndryshme nga kërkesat kombëtare sipas të cilave është lëshuar certifikata ekzistuese.

3. Me përjashtim të paragrafit 2, pika “b” të lartpërmendur, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të vendosë të heqë detyrimin e demonstrimit të pajtueshmërisë nëse ai e konsideron se ky demonstrim krijon një përpjekje të tepruar apo jo proporcionale.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbajë të dhënat, për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh, të dokumenteve që lidhen me procedurën e konvertimit të certifikimit.

Neni 7

Devijimet nga specifikimet e certifikimit

1. Autoriteti i Aviacionit Civil mundet që, deri më 31 dhjetor 2024, të pranojë aplikime për një certifikate që përfshin devijime nga specifikimet e certifikimit të hartuara nga Agjencia dhe të pranuara nga vetë ai, në qoftë se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Devijimet nuk kualifikohen si rast i një niveli ekuivalent të sigurisë teknike sipas ADR.AR.C.020, as nuk kualifikohen si një rast i kushtit të veçantë sipas ADR.AR.C.025 të aneksit II të kësaj rregulloreje;

b) Devijimet kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje;

c) Devijimet kanë respektuar kërkesat thelbësore të shtojcës VII të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të plotësuara me masa zbutëse dhe veprime korrigjuese sipas nevojës;

d) Për çdo devijim është kryer një vlerësim mbështetës mbi sigurinë.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të përpilojë dëshmi që provojnë plotësimin e kushteve të përmendura në paragrafin 1 të mësipërm në një Dokument të Pranimi të Devijimit dhe Veprimit (DPDV). DPDV-ja do t'i bashkëngjitet certifikatës. Autoriteti i Aviacionit Civil do të specifikojë periudhën e vlefshmërisë së DPDV-së.

3. Operatori i aerodromit dhe Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojnë se kushtet e përmendura në paragrafin 1 të mësipërm vazhdojnë të përmbushen. Nëse nuk rezulton kështu DPDV do të ndryshohet, pezullohet ose revokohet.

Neni 8

Ruajtja e rrethinave të aerodromit

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që janë zhvilluar konsultime në lidhje me ndikimet në sigurinë në operim të ndërtimeve të propozuara për t'u bërë brenda kufijve të kufizimeve të pengesave dhe sipërfaqeve mbrojtëse, si dhe sipërfaqeve të tjera të lidhura me aerodromin.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që janë zhvilluar konsultime në lidhje me ndikimet në sigurinë teknike të ndërtimeve të propozuara për t'u ndërtuar përtej kufijve të kufizimeve të pengesave dhe sipërfaqeve mbrojtëse, si dhe sipërfaqeve të tjera që lidhen me aerodromin dhe të cilat tejkalojnë lartësinë e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë koordinimin për ruajtjen e aerodromeve që ndodhen afër kufijve kombëtarë me Shtetet e tjera Anëtare të ZPEA-së (sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe).

Neni 9

Monitorimi i rrethinave të aerodromit

Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që janë zhvilluar konsultime në lidhje me aktivitetet njerëzore dhe përdorimin e tokës, të tilla si:

- a) çdo zhvillim apo ndryshim në përdorimin e tokës në zonën e aerodromit;
- b) çdo zhvillim që mund të krijojë pengesa të shkaktuara nga turbulenca që mund të jenë të rrezikshme për operimet e avionëve;
- c) përdorimi i dritave të rrezikshme, konfuze dhe çorientuese;
- d) përdorimi i sipërfaqeve me reflektim të lartë të cilat mund të shkaktojnë verbim;
- e) krijimi i zonave që mund të nxisin aktivitetin e kafshëve të egra, të rrezikshme për operimet e avionit;
- f) burimet e rrezatimit të padukshëm ose prania e objekteve të lëvizshëm ose të palëvizshëm, të cilët mund të ndërhyjnë ose ndikojnë negativisht në performancën e sistemeve të komunikimit aeronautik, lundrimit dhe mbikëqyrjes.

Neni 10

Menaxhimi i rrezikut të kafshëve të egra

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që rreziku i goditjeve nga kafshët e egra është vlerësuar nëpërmjet:

- a) krijimit të një procedure kombëtare për regjistrimin dhe raportimin e goditjeve të avionit nga kafshët e egra;
- b) grumbullimit të informacionit nga operatorët e avionëve, personeli i aerodromit dhe burime të tjera për praninë e kafshëve të egra që përbëjnë një rrezik potencial për operimet e avionëve; dhe
- c) vlerësimit të vazhdueshëm të rrezikut të kafshëve të egra nga personeli kompetent.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që raportet e goditjeve nga kafshët e egra janë mbledhur dhe dërguar tek ICAO, për përfshirjen në bazën e të dhënave të Sistemit të Informacionit për Goditjet nga Zogjtë (IBIS) të ICAO-s.

Neni 11

Zbatimi

Rregullorja dhe anekset I, II, III dhe IV bashkëlidhur, pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje zbatohen në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

ANEKSI I

Përkufizimet për termat e përdorur në anekset II deri IV

Për qëllim të këtij udhëzimi:

1. **“Mjetet e Pranueshme të Pajtueshmërisë (MPP)”** nënkupton standarde jo të detyrueshme të miratuara nga Agjencia dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për të ilustruar mjetet për

përcaktimin e pajtueshmërisë me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij;

2. **“Distanca e disponueshme e shpejtimit-ndalimit (DDSHN)”** nënkupton gjatësinë e rrugës në dispozicion të ngritjes së avionit plus gjatësinë e zonës së ndalimit, nëse është parashikuar;

3. **“Shërbimi i kontrollit të aerodromit”** nënkupton një shërbim të kontrollit të trafikut ajror (KTA) për trafikun e aerodromit;

4. **“Pajisjet e aerodromit”** nënkupton çdo pajisje, aparat, mekanizëm, program apo aksesor, që është përdorur ose do të përdoret për të kontribuar në operimin e avionit në një aerodrom;

5. **“Të dhënat aeronautike”** nënkupton një përfaqësim të fakteve aeronautike, koncepteve ose udhëzimeve në një formë zyrtare të përshtatshme për komunikim, interpretim apo përpunim;

6. **“Shërbimi i informacionit aeronautik”** nënkupton një shërbim të vendosur brenda zonës së përcaktuar të mbulimit, përgjegjës për ofrimin e informacionit aeronautik dhe të dhënave të nevojshme për sigurinë teknike, rregullsinë, dhe efikasitetin e lundrimit ajror;

7. **“Qarkore e Informacionit Aeronautik (AIC)”** do të thotë një njoftim që përmban informacion që nuk ka të bëjë me burimin e një njoftimi për Pilotin (NOTAM) ose për t’u përfshirë në AIP, por që lidhet me sigurinë e fluturimit, lundrimin ajror, çështjet teknike, administrative ose legjislative;

8. **“Produkt i informacionit aeronautik”** do të thotë të dhëna aeronautike dhe informacione aeronautike të siguruar ose si grupe të të dhënave dixhitale ose si prezantim i standardizuar në media elektronike ose letër. Produktet e informacionit aeronautik përfshijnë sa vijon:

- AIP, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet
- AIC,
- Listat aeronautike,
- NOTAM
- grupe të të dhënave dixhitale;

9. **“Publikimi i Informacionit Aeronautik (AIP)”** do të thotë një botim i lëshuar nga ose me autoritetin e AAC dhe që përmban informacion aeronautik të një karakteri të qëndrueshëm thelbësor për lundrimin ajror; ’

10. **“Shërbimet e lundrimit ajror”** nënkupton shërbimet e trafikut ajror; komunikimit, lundrimit dhe mbikëqyrjes; shërbimet meteorologjike për lundrimin ajror; dhe shërbimet e informacionit aeronautik;

11. **“Shërbimet e trafikut ajror”** nënkupton shërbimet e ndryshme të informacionit të fluturimit, shërbimet e alarmit, shërbimet këshillimore të trafikut ajror dhe shërbimet e kontrollit të trafikut ajror (shërbimet e kontrollit të zonës ajrore, afrimit dhe aerodromit);

12. **“Shërbimi (KTA) i kontrollit të trafikut ajror”** nënkupton një shërbim të ofruar me qëllim:

1. parandalimin e përplasjeve:
 - ndërmjet avionëve,
 - në zonën e manovrimit ndërmjet avionëve dhe pengesave;
2. përshpejtimin dhe mbajtjen e një fluksi të rregullt të trafikut ajror;

13. **“Vendqëndrimi i avionit”** nënkupton një zonë të caktuar mbi një platformë me qëllim që të përdoret për parkimin e një avioni;

14. **“Rruga ndërlidhëse për në vend parkimin e avionëve”** nënkupton një pjesë të vendqëndrimit të avionëve e caktuar si një rrugë ndërlidhëse dhe që do të përdoret vetëm për aksesin e avionëve në vend parkim;

15. **“Mjetet alternative të pajtueshmërisë”** janë ato që propozojnë një alternativë ndaj mjeteve ekzistuese të pranuar të pajtueshmërisë ose ato që propozojnë mjete të reja për përcaktimin e pajtueshmërisë me VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij, për të cilat nga Autoriteti i Aviacionit Civil nuk ka është miratuar asnjë mjet shoqërues i pranuar i pajtueshmërisë;

16. **“Shërbimi i alarmit”** nënkupton një shërbim të ofruar për të njoftuar organizatat përkatëse lidhur me avionin në nevojë për ndihmën e kërkim-shpëtimit, si dhe për t’i ardhur në ndihmë këtyre organizatave sipas rastit;

17. **“Rrugë ndërlidhëse në vendqëndrimin e avionëve”** nënkupton një pjesë të një sistemi të rrugëve ndërlidhëse e vendosur në vendqëndrimin e avionëve dhe që do të sigurojë një rrugë lidhëse hyrëse nëpërmjet vendqëndrimit të avionëve;

18. **“Zonë e pastër (pa pengesa)”** nënkupton një zonë të përcaktuar drejtkëndore në tokë ose në ujë, nën kontrollin e subjektit përkatës, e zgjedhur ose e përgatitur si një zonë e përshtatshme mbi të cilën një aeroplan mund të bëjë një pjesë të ngjitjes së tij fillestare në një lartësi të caktuar;

19. **“Pistë e ndotur”** do të thotë një pistë, sipërfaqja e së cilës (qoftë në zona të izoluara ose jo) brenda gjatësisë dhe gjerësisë që përdoret është e mbuluar në një pjesë të konsiderueshme nga një ose më shumë substanca të renditura nën përshkruesit e gjendjes së sipërfaqes së pistës;

20. **“Mallra të rrezikshme”** nënkupton artikujt ose substancat që janë në gjendje të paraqesin rrezik për shëndetin, sigurinë, pronën apo mjedisin dhe të cilat janë renditur në listën e mallrave të rrezikshme në Udhëzimet Teknike të ICAO-s, ose janë klasifikuar në bazë të këtyre udhëzimeve teknike;

21. **“Lartësia e vendimit ‘decision altitude’ (‘DA’) ose ‘decision height’ (‘DH’)** do të thotë një lartësi specifike *“altitude”* ose *“height”* në një operim me afrim instrumental në 3D në të cilin një procedure e afrimit të munguar duhet të fillohet, nëse referenca vizuale e kërkuar për të vijuar afrimin nuk është përcaktuar;

22. **“Cilësia e të dhënave”** nënkupton një shkallë apo nivel besimi, se të dhënat e ofruara, plotësojnë kërkesat e përdoruesit të këtyre të dhënave lidhur me saktësinë, zbërthimin dhe integritetin;

23. **“Grup i të dhënave”** do të thotë një koleksion i identifikueshëm i të dhënave;

24. **“Distancat e deklaruara”** nënkupton:

- Gjatësinë e pistës në dispozicion për vrullin në ngritje të avionit (GjPDNA),
- Distancën në dispozicion për ngritjen e avionit (DDNA),
- Distancën në dispozicion për përshpejtimin-ndalimin e avionit (DDPNA),
- Distancën në dispozicion për uljen e avionit (DDUA);

25. **“E thatë”**, në lidhje me kushtet e pistës, do të thotë që sipërfaqja e pistës është pa lagështi të dukshme dhe jo e ndotur brenda zonës së parashikuar për t’u përdorur;

26. **“Shërbimi i informacionit të fluturimit”** nënkupton një shërbim të ofruar me qëllim dhënien e këshillave dhe informatave të dobishme për operimin e sigurtë dhe efikas të fluturimeve;

27. **“Mbetjet e objekteve të huaja (FOD)”** do të thotë një objekt i pajetë brenda zonës së lëvizjes i cili nuk ka asnjë funksion operativ ose aeronautik dhe që ka potencialin të jetë rrezik për funksionimin e avionit;

28. **“Parimet e faktorëve njerëzorë”** nënkupton parimet të cilat zbatohen për projektimet aeronautike, certifikimet, trajnimet, operimet dhe mirëmbajtjen dhe të cilat kërkojnë ndërlidhje të sigurtë ndërmjet njeriut dhe komponentëve të tjerë të sistemit duke marrë në konsideratë performancën njerëzore;

29. **“Performanca njerëzore”** nënkupton aftësitë dhe kufizimet njerëzore të cilat kanë një ndikim në sigurinë dhe efikasitetin e operateve aeronautike;

30. **“Pistë me instrumente”** nënkupton një nga llojet e mëposhtme të pistave që do të shërbejnë për operimin e avionëve duke përdorur procedurat me mjetet e afrimit instrumental:

1. **“Pistë me afrim jo preciz”**: një pistë me shërbim të ofruar nga mjetet vizuale dhe të paktën një ndihmë jo-vizuale, e destinuar për operate uljeje në vijim të një operimi të afrimit me instrument të tipit A;

2. **“Pistë me afrim preciz, kategoria I”**: një pistë me shërbim të ofruar nga mjetet vizuale dhe të paktën një ndihmë jo-vizuale, e destinuar për operate uljeje pas një operacioni të afrimit me instrument të tipit B KAT I;

3. **“Pistë me afrim preciz, kategoria II”**: një pistë me shërbim të ofruar nga mjetet vizuale dhe të paktën një ndihmë jo-vizuale, e destinuar për operime uljeje pas një operimi të afrimit me instrument të tipit B KAT II;

4. **“Pistë me afrim preciz, kategoria III”**: një pistë me shërbim të ofruar nga mjetet vizuale dhe të paktën një ndihmë jo-vizuale, e destinuar për operime uljeje pas një operimi të afrimit me instrument të tipit B KAT IIIA;

31. **“Integriteti”** nënkupton shkallën e sigurisë që një e dhënë aeronautike dhe vlera e saj nuk kanë humbur apo ndryshuar që nga të dhënat origjinale ose nga ndryshimi i autorizuar.

32. **“Distanca në dispozicion për ulje (DDU)”** nënkupton gjatësinë e pistës e cila është deklaruar si e disponueshme dhe e përshtatshme për lëvizjen në tokë të një aeroplani që është duke u ulur.

33. **“Besueshmëria e sistemit të ndriçimit”** do të thotë probabiliteti që instalimi i plotë të funksionojë brenda tolerancave të specifikuara dhe sistemi është i përdorshëm në mënyrë operative;

34. **“Treguesit e vendndodhjes”** do të thotë botimi më i fundit efektiv i “Tregueseve të vendndodhjes” (Doc. 7910), i miratuar dhe botuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;

35. **“Operimet me shikueshmëri të ulët (LVOs)”** do të thotë operime afrimi ose ngritjeje në një pistë me një diapazon shikimi të pistës më të ulët se 550 m ose një lartësi vendimi më të ulët se 200 ft;

36. **“Procedurat në shikueshmëri të ulët”** nënkupton procedurat që zbatohen në një aerodrom me qëllim garantimin e operimeve të sigurta gjatë afrimeve në shikueshmëri më të ulët;

37. **“Ngritje (take-off) me shikueshmëri të ulët (LVTO)”** nënkupton një ngritje me një diapazon të shikueshmërisë së pistës më të ulët se 500 m;

38. **Qëllimisht e lënë bosh.**

39. **“Zona e manovrimit”** nënkupton atë pjesë të një aerodromi e cila do të përdoret për ngritjen, uljen dhe lëvizjen e avionëve, duke përjashtuar këtu vendqëndrimet e avionëve.

40. **“Shërbimet meteorologjike”** nënkupton ato facilitete dhe shërbime që i ofrojnë avionëve parashikime, përmbledhje dhe vëzhgime meteorologjike, si dhe çdo informacion dhe të dhëna të tjera meteorologjike të siguruar nga Shqipëria për përdorim aeronautik;

41. **“Shënues (marker)”** nënkupton një objekt të vendosur mbi sipërfaqen e tokës, me qëllim për të treguar një pengesë ose për të përcaktuar një kufi.

42. **“Shenjë (marking)”** nënkupton një simbol ose grup simbolesh të vendosura mbi sipërfaqen e zonës së lëvizjes me qëllim përcjelljen e informacioneve aeronautike;

43. **“Zona e lëvizjes”** nënkupton atë pjesë të aerodromit që do të përdoret për ngritjen, uljen dhe lëvizjen e avionëve, duke përfshirë këtu dhe zonën e manovrimit dhe të vendqëndrimit të avionëve.

44. **“Shërbimet e lundrimit”** nënkupton ato facilitete dhe shërbime që i ofrojnë avionëve informacionin e pozicionimit dhe koordinimit;

45. **“Pistë pa instrumente”** nënkupton një pistë që do të shërbejë për operimin e avionëve duke përdorur procedurat vizuale të afrimit;

46. **“Njoftim për pilotët (NOTAM)”** do të thotë një njoftim i shpërndarë me anë të telekomunikacionit që përmban informacion në lidhje me vendosjen, gjendjen ose ndryshimin në çdo objekt, shërbim, procedurë ose rrezik aeronautik, njohja në kohë e së cilit është thelbësor për personelin që merret me operacionet e fluturimit;

47. **“Kodi NOTAM”** do të thotë kodi që përmbahet në botimin më të fundit efektiv të “Procedurave për shërbimet e lundrimit ajror – shkurtesat dhe kodet e ICAO” (PANS ABC – Doc 8400), miratuar dhe botuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;

48. **“Operim me kredite operimi”** do të thotë një operim që përdor avion specifik ose pajisje në tokë, ose një kombinim të avionit dhe pajisjeve në tokë që lejon secilin nga elementet:

a) Zbatimin e një minimumi operimi më të ulët se minimumi standard i operimit, për një klasifikim të veçantë të operimit;

b) Kërkesat e shikueshmërisë mund të përmbushen apo reduktohen;

c) Kërkohen më pak facilitete në tokë;

49. Qëllimisht e lënë bosh;

50. **“Cikli i planifikimit të mbikëqyrjes”** nënkupton një periudhë kohore në të cilën verifikohet përputhshmëria e vazhdueshme;

51. **“Rruga ndërlidhëse për dalje të shpejtë”** nënkupton një rrugë ndërlidhëse e lidhur me një pistë në një kënd të ngushtë dhe e projektuar për t’i mundësuar avionëve të uljes që të kthehen me një shpejtësi më të madhe se ajo që arrihet te rrugët e tjera dalje, duke minimizuar si rrjedhojë kohën e zënies së pistës;

52. **“Pistë”** nënkupton një zonë të caktuar drejtkëndore në një aerodrom tokësor e përgatitur për uljen dhe ngritjen e avionëve;

53. **“Matrica e vlerësimit të gjendjes së pistës (RCAM)”** nënkupton një matricë që lejon vlerësimin e kodit të gjendjes së pistës (RWYCC), duke përdorur procedurat e shoqëruara, nga një grup i kushteve të vëzhguara të sipërfaqes së pistës dhe raportit pilot të veprimit të frenimit;

54. **“Kodi i gjendjes së pistës (RWYCC)”** nënkupton një numër, që do të përdoret në raportin e gjendjes së pistës (RCR), që përshkruan efektin e gjendjes së sipërfaqes së pistës në performancën e ngadalësimit të aeroplanit dhe kontrollin anësor;

55. **“Raporti i gjendjes së pistës (RCR)”** do të thotë një raport gjithëpërfshirës i standardizuar që lidhet me kushtet e sipërfaqes së pistës dhe efektet e tyre në performancën e uljes dhe ngritjes së aeroplanit, të përshkruar me anë të kodit të kushteve të pistës;

56. **“Zona e sigurisë në fund të pistës (RESA)”** do të thotë një zonë simetrike në lidhje me vijën qendrore të pistës dhe ngjitur me fundin e shiritit e destinuar kryesisht për të zvogëluar rrezikun e dëmtimit të aeroplanit që nuk e arrin ose tejkalon pistën;

57. **“Mbajtje e pozicionit në pistë”** do të thotë një pozicion i caktuar i destinuar për të mbrojtur pistën, një sipërfaqe kufizuese pengesash ose një zonë kritike ose e ndjeshme e Sistemeve të Uljes së Instrumentit (ILS) ose Sistemit Mikrovale i Uljes (MLS) në të cilën avionët taksi dhe automjetet duhet të ndalen dhe të qëndrojnë, përveç nëse autorizohet ndryshe nga kulla e kontrollit të aerodromit;

58. **“Shirit piste”** do të thotë një zonë e përcaktuar, përfshirë pistën dhe vend ndalimin, nëse parashikohet, që synon të:

a) të zvogëlojë rrezikun e dëmtimit të avionëve që ngrihen nga pista;

b) të mbrojë avionët që fluturojnë mbi të gjatë operacioneve të ngritjes ose uljes;

59. **“Gjendje e sipërfaqes së pistës”** do të thotë përshkrimi i gjendjes së sipërfaqes së pistës së përdorur në RCR që krijon bazën për përcaktimin e RWYCC për qëllime të performancës së aeroplanit;

60. **“Përshkruesit e gjendjes së sipërfaqes së pistës”** do të thotë një nga substancat e mëposhtme në sipërfaqen e pistës:

a) dëborë e ngjeshur: dëborë që është ngjeshur në masë të ngurtë, në mënyrë të tillë që gomat e aeroplanit, gjatë presionit dhe ngarkesave operative, do të kalojnë në sipërfaqe pa ngjeshje të mëtejshme ose deformim të sipërfaqes;

b) dëborë e thatë: dëborë nga e cila nuk mund të krijohet lehtë një top dëborë;

c) ngrica: kristalet e akullit të formuara nga lagështia e ajrit në një sipërfaqe temperatura e së cilës është në ose nën ngrirje; ngrica ndryshon nga akulli për shkak se kristalet e ngricave rriten në mënyrë të pavarur dhe për këtë arsye, kanë strukturë më të grimcuar;

d) akull: ujë që ka dëborë të ngrirë ose të ngjeshur që ka kaluar në akull në kushte të ftohta dhe të thata;

e) dëborë e shkrirë: dëborë që është aq e ngopur me ujë sa uji kullon prej saj kur merret një grusht ose lëshon spërkata nëse e shkel me forcë;

f) Ujë i ndenjmur: ujë me thellësi më të madhe se 3 mm;
g) akull i lagësht: akulli me ujë në majë të tij ose akulli që po shkrihet;
h) dëbora e lagësht: dëbora që përmban mjaftueshëm ujë për të formuar një top dëbore të ngurtë, por uji nuk depërton jashtë.

61. **“Tipi i pistës”** nënkupton një pistë me instrumente apo pistë pa instrumente;

62. **“Diapazoni i shikueshmërisë të pistës (DSHP)”** nënkupton diapazonin mbi të cilin piloti i një avioni në aksin e pistës (vijën qendrore të pistës) mund të shikojë shenjat ose dritat e pistës apo të identifikojë aksin e saj;

63. **“Sistemi i menaxhimit të sigurisë (safety)”** nënkupton një qasje sistematike në menaxhimin e sigurisë duke përfshirë strukturën e nevojshme organizative, përgjegjësitë, politikat dhe procedurat;

64. **“Pistë e lagësht e rrëshqitshme”** do të thotë pistë e lagur, karakteristikat e fërkimit sipërfaqësor të së cilës për një pjesë të konsiderueshme të saj janë përcaktuar të degradohen;

65. **“SNOWTAM”** do të thotë:

a) me efekt nga 7 janari 2021 deri më 12 gusht 2021, një seri e posaçme ku NOTAM njofton praninë ose heqjen e kushteve të rrezikshme për shkak të dëborës, akullit, llucës, ose ujit të ndenjmur në lidhje me dëborën, dëborën e shkrirë dhe akullin në zonën e lëvizjes, me anë të një formati specifik;

b) me efekt nga 12 gushti 2021, një seri e posaçme NOTAM gjeneruar në një format standard, i cili siguron një raport të gjendjes sipërfaqësore që njofton praninë ose ndërprerjen e kushteve për shkak të dëborës, akullit, llucës, acarit ose ujit të shoqëruar me dëborë, dëborë e shkrirë, akull ose ngricë në zonën e lëvizjes;

66. **“Pistë dimërore e përgatitur posaçërisht”** do të thotë një pistë me një sipërfaqe të thatë të ngrirë dëbore ose akulli të ngjeshur, ose të dyja, e cila është trajtuar me rërë ose zhavorr ose është trajtuar mekanikisht për të përmirësuar fërkimin me pistën;

67. **“Zona e ndalimit (Stopway)”** nënkupton një zonë të përcaktuar drejtkëndore në tokë, në fund të distancës në dispozicion për ngritje (GjPDNA), e parapërgatitur si një zonë e përshtatshme në të cilën një avion mund të ndalet në rastin e anulimit të një ngritjeje.

68. **“Distanca në dispozicion për ngritje (DDNA)”** nënkupton gjatësinë në dispozicion për marrjen vrull në ngritje plus gjatësinë e zonës së pastër (*clearway*), nëse parashikohet.

69. **“Gjatësia në dispozicion për vrullin në ngritje (GjPDNA)”** nënkupton gjatësinë e pistës së deklaruar si e disponueshme dhe e përshtatshme për marrjen vrull në tokë të një avioni në ngritje;

70. **“Rruga ndërlidhëse (Taxiway)”** nënkupton një rrugë të përcaktuar në një aerodrom tokësor që shërben për ecjen e avionit dhe për realizimin e një ndërlidhjeje midis një pjese të aerodromit dhe një tjetre, duke përfshirë këtu:

- Rrugët ndërlidhëse të avionëve në vend parkim;
- Rrugët ndërlidhëse në vendqëndrimin e avionëve;
- Rrugët ndërlidhëse me dalje të shpejtë;

71. **“Udhëzime teknike”** nënkupton botimin më të fundit në fuqi të “Udhëzimeve teknike për transportin e sigurt ajror të mallrave të rrezikshme” (Dokumenti 9284-AN/905), duke përfshirë çdo shtesë dhe shtojcë, të miratuar dhe të publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;

72. **“Kushtet e certifikatës”** nënkupton sa vijon:

- treguesit e vendndodhjes së ICAO;
- kushtet për të operuar (VFR/IFR, ditë/natë);
- operacionet e aeroplanit në pistat dimërore të përgatitura posaçërisht;
- pistë;
- distancat e deklaruara;
- llojet dhe qasjet e pistës;
- kodi referues i aerodromit;
- fushëveprimi i operacioneve të avionëve me shkronjë më të lartë të kodit referues të aerodromit,

- sigurimi i shërbimeve të menaxhimit të platformës (po/jo);
- niveli i mbrojtjes së shpëtimit dhe zjarrefikjes;

73. **“Operim i afrimit me instrument të tipit A”** do të thotë një operim i afrimit me instrument me një lartësi minimale të zbritjes ose lartësi të përcaktuar në ose mbi 75 metra (250 ft);

74. **“Operim i afrimit me instrument të tipit B”** nënkupton një operim të afrimit me instrument me një lartësi vendimit nën 75 m (250 ft) të kategorizuar si në vijim:

1. Kategoria I (CAT I): një lartësi e vendimit jo më e ulët se 60 m (200 ft) dhe me një shikueshmëri jo më pak se 800 m ose një diapazon të shikueshmërisë së pistës jo më pak se 550 m;
2. Kategoria II (CAT II): një lartësi e vendimit më e ulët se 60 m (200 ft), por jo më e ulët se 30 m (100 ft) dhe një diapazon të shikueshmërisë së pistës më pak se 300 m;
3. Kategoria IIIA (CAT IIIA): një lartësi e vendimit më e ulët se 30 m (100 ft) ose asnjë lartësi vendimi dhe një diapazon të shikueshmërisë së pistës jo më pak se 300 m ose asnjë kufizim të diapazonit të shikueshmërisë së pistës;

75. **“Mjete ndihmëse vizuale”** do të thotë treguesit dhe pajisjet e sinjalizimit, shënjimët, dritat, shenjat dhe shënuesit ose kombinimet e tyre;

76. **“Pistë e lagësht”** do të thotë një pistë, sipërfaqja e së cilës është e mbuluar me lagështirë të dukshme ose ujë duke përfshirë 3 mm thellësi brenda zonës së parashikuar për t’u përdorur.

ANEKSI II

KËRKESAT E AUTORITETIT – AERODROMET (PJESA ADR.AR)

NËNPJESA A – KËRKESA TË PËRGJITHSHME (ADR.AR.A)

ADR.AR.A.001 Qëllimi

Ky aneks përcakton kërkesat për Autoritetin e Aviacionit Civil përgjegjës, për:

- a) certifikimin dhe mbikëqyrjen e aerodromeve dhe operatorëve të aerodromit;
- b) marrja e deklaratave të aftësisë dhe disponueshmëria e mjeteve për të kryer përgjegjësitë nga organizatat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të pistës dhe mbikëqyrjen e tyre.

ADR.AR.A.005 Autoriteti Kompetent

Autoriteti i Aviacionit Civil do të jetë përgjegjës, për:

- a) certifikimin dhe mbikëqyrjen e aerodromeve dhe operatorëve të tyre;
- b) marrja e deklaratave të aftësisë dhe disponueshmëria e mjeteve për të shkarkuar përgjegjësitë nga organizatat përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit dhe mbikëqyrjen e tyre.

ADR.AR.A.010 Dokumentacioni i mbikëqyrjes

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do t’ia vërë në dispozicion aktet ligjore, standardet, rregullat, publikimet teknike dhe dokumentet përkatëse, personelit të tij, në mënyrë që ata të kryejnë detyrat e caktuara dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion aktet ligjore, standardet, rregullat, botimet teknike dhe dokumentet përkatëse për operatorët e aerodromit, organizatat përgjegjëse për sigurimin e AMS-së dhe palët e tjera të interesuara për të lehtësuar pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e zbatueshme.

ADR.AR.A.015 Mjetet e pajtueshmërisë

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të pranojë dhe përdorë mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë (MPP) të zhvilluara nga Agjencia, të cilat do të përdoren për të krijuar përputhjen me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij. Kur mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë janë plotësuar, atëherë janë përmbushur edhe kërkesat përkatëse të rregullave zbatuese.

b) Për të vendosur pajtueshmërinë me rregullat zbatuese mund të përdoren mjetet alternative të pajtueshmërisë.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të krijojë një sistem për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme se mjetet alternative të pajtueshmërisë të përdorura nga ai ose nga operatorët e aerodromit apo ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit nën mbikëqyrjen e tij sigurojnë pajtueshmërinë me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe me rregullat zbatuese të tij.

d) Autoriteti i Aviacionit Civil do të vlerësojë mënyrat alternative të pajtueshmërisë të propozuara nga një operator i aerodromit ose një organizatë përgjegjëse për sigurimin e AMS, në përputhje me pikën ADR.OR.A.015, duke analizuar dokumentacionin e ofruar dhe, nëse konsiderohet e nevojshme, duke kryer një inspektim operatorit të aerodromit, aerodromit ose organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së.

Kur Autoriteti i Aviacionit Civil konstaton se mjetet alternative të pajtueshmërisë të propozuara nga operatori i aerodromit ose ofruesi i shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit janë në pajtueshmëri me rregullat e zbatimit, ai duhet që, pa ndonjë vonesë të pa justifikuar:

1. të njoftojë aplikantin se mjetet alternative të pajtueshmërisë mund të zbatohen dhe, nëse është e aplikueshme, të ndryshojë certifikatën ose miratimin e aplikantit në përputhje me rrethanat;

2. të informojnë Agjencinë për përmbajtjen e tyre, duke përfshirë kopjet e dokumentacionit përkatës;

3. kur është e zbatueshme, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, të informojë shtetet e tjera anëtare të ZPEA-së sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe në lidhje me mjetet alternative të pajtueshmërisë që u pranuan; dhe

4. do të informojë aerodromet e certifikuar dhe organizatën përgjegjëse për sigurimin e AMS-së nën mbikëqyrjen e saj, sipas rastit.

e) Kur vetë Autoriteti i Aviacionit Civil përdor mjete alternative të pajtueshmërisë për të arritur pajtueshmërinë me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat e zbatueshme të tij, ai duhet:

1. t’i verë ato në dispozicion të operatorëve të aerodromit dhe ofruesve të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit që janë nën mbikëqyrjen e tij; dhe

2. kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, të njoftojë pa vonesë Agjencinë.

Autoriteti i Aviacionit Civil do t’i sigurojë Agjencisë një përshkrim të plotë të mjeteve alternative të pajtueshmërisë, duke përfshirë çdo rishikim të procedurave që mund të jenë të përshtatshme, si dhe një vlerësim duke demonstruar se janë plotësuar rregullat zbatuese.

ADR.AR.A.025 Informacioni për Agjencinë

a) Kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë pa vonesë Agjencinë në rast të ndonjë problemi të rëndësishëm me zbatimin e VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullave zbatuese të tij.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion të Agjencisë, informacionet e rëndësishme që lidhen me sigurinë në operim, të cilat rrjedhin nga raportet sinjalizuese të ngjarjeve që ajo ka marrë.

ADR.AR.A.030 Reagimi i menjëhershëm për një problem të sigurisë në operim

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të zbatojë një sistem për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë në mënyrë të përshtatshme informacionin e sigurisë në përputhje me urdhrin e ministrit përgjegjës për Transportin nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores ‘Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë’”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Agjencia zbaton një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion të marrë që lidhet me sigurinë teknike dhe pa vonesa të panevojshme do t’i japë Shteteve Anëtare të ZPEA-së dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet apo veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren, të nevojshme për ata që të reagojnë në kohën e duhur, për një problem të

sigurisë teknike që përfshin aerodromet, operatorët e aerodromit dhe ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit, të cilët i nënshtrohen Rregullores EU nr. 2018/1139, të Parlamentit dhe Këshillit, transpozuar me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullave zbatuese të tij.

c) Me marrjen e informacionit të referuar në pikat “a” dhe kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe në pikën “b”, të lartpërmendura, Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masat e duhura për të adresuar problemin e sigurisë në operim, duke përfshirë dhënien e direktivave të sigurisë teknike në përputhje me ADR.AR.A.040.

d) Masat e marra në përputhje me pikën c) do t’u njoftohen menjëherë operatorëve të aerodromit ose organizatave përgjegjëse për sigurimin e AMS të cilat duhet të jenë në përputhje me to VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të tyre. AAC, kur është e zbatueshme, gjithashtu do të njoftojë Agjencinë për ato masa dhe, kur kërkohet veprim i kombinuar, Shtetet e tjera Anëtare të interesuara.

e) Masat e njoftuara për një organizatë përgjegjëse për sigurimin e AMS-ës do t’i njoftohen gjithashtu operatorit të aerodromit ku ofrohet shërbimi.

ADR.AR.A.040 Direktivat e sigurisë në operim (*safety*)

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të nxjerrë një udhëzues të sigurisë në operim (*safety*) në qoftë se ai ka përcaktuar ekzistencën e një gjendjeje të pasigurt që kërkon veprim të menjëhershëm, duke përfshirë paraqitjen e pajtueshmërisë me çdo specifikim të ndryshuar ose shtesë të certifikimit të vendosur nga Autoriteti i Aviacionit Civil, nëse ai e sheh si të nevojshme.

b) Një udhëzues i sigurisë në operim do të përcillet tek operatorët e aerodromit apo ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit në fjalë, sipas rastit, dhe duhet të përmbajë si minimum, informacionin e mëposhtëm:

1. identifikimin e gjendjes të pasigurt;
2. identifikimin e projektit, pajisjeve, apo operimeve që preken;
3. veprimet e kërkuara dhe arsyetimi i tyre, duke përfshirë specifikimet e ndryshuara ose shtesë të certifikimit që duhen përmbushur;
4. afatin kohor për përputhjen me veprimet e kërkuara; dhe
5. datën e hyrjes në fuqi të saj.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil do t’i dërgojë Agjencisë një kopje të direktivës së sigurisë në operim.

d) Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojë pajtueshmërinë e operatorëve të aerodromit dhe të ofruesve të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit me direktivat e zbatueshme të sigurisë në operim.

e) Direktivat e sigurisë të njoftuara për organizatën përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do t’i njoftohen gjithashtu operatorit të aerodromit ku ofrohet shërbimi.

NËNPJESA B – MENAXHIMI (ADR.AR.B)

ADR.AR.B.005 Sistemi i menaxhimit

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të krijojë dhe do të mbajë një sistem të menaxhimit, duke përfshirë si minimum:

1. politikat dhe procedurat e dokumentuara për të përshkruar organizimin e tij, mjetet dhe metodat për të arritur pajtueshmërinë me udhëzimin nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe rregullat zbatuese të tij. Procedurat do të mbahen të përditësuara dhe do të shërbejnë si dokumente themelore të punës brenda Autoritetit të Aviacionit Civil për të gjitha detyrat që lidhen me të;

2. një numër të mjaftueshëm personeli, duke përfshirë inspektorët e aerodromit, për të kryer detyrat dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tyre. Ky personel do të jetë i kualifikuar për të kryer

detyrat e caktuara dhe do të ketë njohuritë e nevojshme, përvojën, trajnimin fillestar, trajnimin në vendin e punës dhe trajnimin periodik për të garantuar kompetencën e vazhdueshme. Duhet të ekzistojë një sistem për planifikimin e disponueshmërisë së personelit, me qëllim realizimin e të gjitha detyrave përkatëse;

3. facilitetet e nevojshme dhe zyrat për të kryer detyrat e përcaktuara;

4. një proces formal për të monitoruar pajtueshmërinë e sistemit të menaxhimit me kërkesat përkatëse dhe përshtatshmërinë e procedurave, duke përfshirë krijimin e një procesi të auditimit të brendshëm dhe një procesi të menaxhimit të rrezikut të sigurisë (*safety*).

b) Autoriteti i Aviacionit Civil, për çdo fushë të aktivitetit të përfshira në sistemin e menaxhimit, do të caktojë një ose më shumë persona me përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin e detyrave përkatëse.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të vendosë procedurat për pjesëmarrjen në një shkëmbim të ndërsjellë të të gjithë informacionit dhe ndihmës së nevojshme me autoritetet e tjera kompetente të interesuara, duke përfshirë informacionin mbi të gjitha gjetjet e ngritura, veprimet korrigjuese të ndjekjes të ndërmarra në përgjigje të këtyre informacioneve dhe masat e zbatimit të marra si rezultat i mbikëqyrjes së organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së të regjistruar në më shumë se një Shtet Anëtar.

ADR.AR.B.010 Shpërndarja e detyrave të subjektet e kualifikuara

a) Detyrat që lidhen me certifikimin fillestar apo mbikëqyrjen e vazhdueshme të personave apo organizatave që i nënshtrohen VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullave zbatuese të tij, do të shpërndahen nga Autoriteti i Aviacionit Civil vetëm te subjektet e kualifikuara. Kur bëhet ndarja e detyrave, Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që ai ka:

1. të ndërtuar një sistem për vlerësimin fillestar dhe në vazhdimësi i cili garanton se subjekti i kualifikuar është në pajtueshmëri me shtojcën VI të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”; ky sistem dhe rezultatet e vlerësimeve do të dokumentohen;

2. ka vendosur një marrëveshje të dokumentuar me subjektin e kualifikuar, të miratuar nga të dyja palët në nivelin e duhur të menaxhimit, e cila përcakton në mënyrë të qartë:

i) detyrat që do të kryhen;

ii) deklaratat, raportet dhe të dhënat që do të ofrohen;

iii) kushtet teknike që duhet të plotësohen në kryerjen e detyrave të tilla;

iv) mbulimin përkatës të përgjegjësisë; dhe

v) mbrojtjen e dhënë për informacionin e marrë në kryerjen e detyrave të tilla.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë se procesi i auditimit të brendshëm dhe procesi i menaxhimit të rrezikut të sigurisë në operim (*safety*) të kërkuara nga ADR.AR.B.005 a/4 mbulojnë të gjitha detyrat e certifikimit ose të mbikëqyrjes së vazhdueshme të kryera në emër të tij.

ADR.AR.B.015 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të vendosë një sistem për të identifikuar ndryshimet që ndikojnë në aftësinë për të kryer detyrat e tij dhe për të përmbushur përgjegjësitë e veta të përcaktuara në VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij. Ky sistem do të mundësojë që ai të marrë masa, sipas nevojës, për të siguruar që sistemi i menaxhimit të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të përditësojë sistemin e tij të menaxhimit për të pasqyruar çdo ndryshim të mundshëm në VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij në kohën e duhur, me qëllim sigurimin e zbatimit efektiv.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë Agjencinë për ndryshimet që ndikojnë në aftësinë e tij për të kryer detyrat dhe përmbushur përgjegjësitë e veta të përcaktuara në VKM nr. 1095, datë

24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij.

ADR.AR.B.020 Mbajtja e të dhënave

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të krijojë një sistem të mbajtjes së të dhënave për të siguruar ruajtjen e përshtatshme, qasjen dhe gjurmueshmërinë e besueshme, të:

1. politikave dhe procedurave të dokumentuara të sistemit të menaxhimit;
2. trajnimit, kualifikimit dhe autorizimit të personelit të tij;
3. ndarjes së detyrave për subjektet e kualifikuara, që mbulojnë elementet e kërkuara nga ADR.AR.B.010, si dhe detajet e detyrave të ndara;

4. procesit të certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të aerodromeve dhe operatorëve të aerodromit;

5. procesit të deklarimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të ofruesve të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit;

6. dokumentacionit që lidhet me rastet e nivelit ekuivalent të parrezikshmërisë dhe kushteve të veçanta të përfshira në bazën e certifikimit, si dhe çdo Dokument të Pranimit të Devijimit dhe Veprimit (DPDV);

7. vlerësimit dhe njoftimit tek Agjencia të mjeteve alternative të pajtueshmërisë të propozuara nga operatorët e aerodromit dhe ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit dhe vlerësimit të mjeteve alternative të pajtueshmërisë të përdorura nga vetë Autoriteti i Aviacionit Civil;

8. gjetjeve të mangësive, veprimeve korrigjuese dhe datën e mbylljes së veprimeve, si dhe vërejtjet;

9. masave detyruese të marra;

10. informacioneve të sigurisë në operim dhe masat për ndjekjen e tyre;

11. përdorimi i dispozitave të fleksibilitetit në përputhje me nenin 71 të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbajë një listë për të gjitha certifikatat e lëshuara dhe deklaratat e marra.

c) Shënimet që kanë të bëjnë me certifikimin e një aerodromi dhe të një operatori të aerodromit, ose shpalljen e një ofruesi të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit do të mbahen për gjithë jetëgjatësinë e certifikatës ose deklaratës, sipas rastit.

d) Shënimet lidhur me pikat a/1 deri në a/3 dhe pikat a/7 deri në a/11 do të mbahen për një periudhë minimale prej pesë vjetësh, në varësi të ligjit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave.

NËNPJESA C – MBIKËQYRJA, CERTIFIKIMI DHE MASAT DETYRUESE (ADR.AR.C)

ADR.AR.C.005 Mbikëqyrja

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojë:

1. pajtueshmërinë me bazën e certifikimit dhe të gjitha kërkesat e aplikueshme për aerodromet dhe operatorët aerodromit, përpara lëshimit të një certifikatë miratimi;

2. pajtueshmëria e vazhdueshme me bazën e certifikimit dhe kërkesat e zbatueshme të aerodromeve dhe operatorëve të aerodromit ose organizatave përgjegjëse për sigurimin e AMS-së; dhe

3. zbatimin e masave të përshtatshme të sigurisë në operim, siç përcaktohet në ADR.AR.A.030 “c” dhe “d”.

b) Ky verifikim, do të:

1. mbështetet nga dokumentacioni që synon të pajisë në mënyrë specifike personelin përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë në operim me udhëzime për kryerjen e funksioneve të tyre;

2. pajisë me rezultatet e aktivitetit të mbikëqyrjes të sigurisë në operim operatorët e aerodromit dhe ofruesit e interesuar të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve;

3. bazohet në auditimet dhe inspektimet, duke përfshirë inspektimet e paparalajmëruara, kur është e përshtatshme; dhe

4. pajisë Autoritetin e Aviacionit Civil me provat e nevojshme në rast se kërkohen veprime të mëtejshme, duke përfshirë edhe masat e parashikuara në ADR.AR.C.055.

c) Shtrirja e mbikëqyrjes do të marrë parasysh rezultatet e aktiviteteve të mbikëqyrjes së fundit dhe prioritetet e identifikuar të sigurisë në operim.

d) Autoriteti i Aviacionit Civil do të grumbullojë dhe përpunojë çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për mbikëqyrjen, duke përfshirë inspektimet e paparalajmëruara, sipas rastit.

e) Në kuadër të kompetencave të tij mbikëqyrëse, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të vendosë të kërkojë miratimin paraprak për çdo pengesë, për zhvillimet dhe aktivitetet e tjera brenda zonave të monitoruara nga operatori i aerodromit në përputhje me ADR.OPS.B.075, të cilat mund të rrezikojnë sigurinë dhe të ndikojnë negativisht në operimin e aerodromit.

ADR.AR.C.010 Programi i mbikëqyrjes

a) Autoriteti i Aviacionit Civil, për secilin operator dhe organizatë të aerodromit përgjegjës për sigurimin e AMS-së:

1. vendos dhe mirëmbajë një program të mbikëqyrjes, i cili mbulon aktivitetet e mbikëqyrjes të kërkuara nga ADR.AR.C.005;

2. aplikon një cikël të planifikimit të duhur të mbikëqyrjes që nuk i kalon 48 muaj.

b) Programi i mbikëqyrjes duhet të përfshijë brenda çdo cikli të planifikimit të mbikëqyrjes, auditime dhe inspektime, duke përfshirë inspektimet e paparalajmëruara, sipas rastit.

c) Programi i mbikëqyrjes dhe cikli i planifikimit duhet të pasqyrojnë performancën e sigurisë së operatorit të aerodromit ose organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së përkatësisht, si dhe ekspozimin ndaj rrezikut të aerodromit.

d) Programi i mbikëqyrjes do të përfshijë të dhënat e datave kur duhet të kryhen auditimet dhe inspektimet dhe kur janë kryer ato faktikisht.

ADR.AR.C.015 Fillimi i procesit të certifikimit

a) Me marrjen e një aplikimi për lëshimin fillestar të një certifikate, Autoriteti i Aviacionit Civil do të vlerësojë aplikimin dhe do të verifikojë përputhjen me kërkesat e zbatueshme.

b) Në rastin e një aerodromi ekzistues, Autoriteti i Aviacionit Civil do të përcaktojë kushtet sipas të cilave do të operojë operatori i aerodromit gjatë periudhës së certifikimit, përveç se kur Autoriteti i Aviacionit Civil përcakton se operimi i aerodromit duhet të pezullohet. Autoriteti i Aviacionit Civil do të informojë operatorin e aerodromit për grafikun e parashikuar për procesin e certifikimit dhe do të përfundojë certifikimin brenda periudhës së kohës më të shkurtër që mund të arrihet praktikisht.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të përcaktojë dhe do të njoftojë aplikuesin për bazën e certifikimit në përputhje me ADR.AR.C.020.

ADR.AR.C.020 Baza e certifikimit

Baza e certifikimit do të përcaktohet dhe do t'i njoftohet një aplikanti nga Autoriteti i Aviacionit Civil dhe do të përbëhet nga:

a) specifikimet e certifikimit të hartuara nga Agjencia dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të cilat AAC-ja i gjen të zbatueshme për projektin dhe llojin e operimit të aerodromit dhe të cilat janë në fuqi në datën e aplikimit për atë certifikate, përveçse, kur:

1. aplikanti zgjedh pajtueshmërinë me ndryshimet me fuqi të mëvonshme; ose

2. Autoriteti i Aviacionit Civil konstaton se pajtueshmëria me këto ndryshime me fuqi të mëvonshme është e nevojshme;

b) çdo dispozitë për të cilën është pranuar një nivel ekuivalent i sigurisë në operim nga Autoriteti i Aviacionit Civil, do të demonstronhet nga aplikanti; dhe

c) çdo kusht i veçantë i përshkruar në përputhje me ADR.AR.C.025, të cilin Autoriteti i Aviacionit Civil e gjen të nevojshëm, do të përfshihet në bazën e certifikimit.

ADR.AR.C.025 Kushtet e veçanta

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të përcaktojë për një aerodrom specifikime të veçanta të detajuara teknike, të quajtura kushte të veçanta, nëse specifikimet që lidhen me certifikimin të hartuara nga Agjencia, të referuara në pikën ADR.AR.C.020a) janë të pamjaftueshme ose të papërshtatshme, për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat thelbësore të aneksit VII të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, sepse:

1. specifikimet e certifikimit nuk mund të përmbushen për shkak të kufizimeve fizike, topografike ose kufizimeve të ngjashme në lidhje me vendndodhjen e aerodromit;

2. aerodromi ka karakteristika të reja ose të pazakonshme të projektimit; ose

3. përvoja nga operimi i atij aerodromi ose aerodromeve të tjera që kanë karakteristika të ngjashme të projektimit ka treguar se mund të rrezikohet siguria në operim.

b) Kushtet e veçanta duhet të përmbajnë specifikime të tilla teknike, duke përfshirë kufizimet ose procedurat që duhen plotësuar, të cilat Autoriteti i Aviacionit Civil i gjen të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin VII të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”.

ADR.AR.C.035 Lëshimi i certifikatave

a) Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kërkojë çdo inspektim, testim, vlerësim të sigurisë teknike, ose ushtrim demonstrues të cilin ai e shikon të nevojshëm përpara lëshimit të certifikatës.

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë ose:

1. një certifikatë aerodromi të vetme; ose

2. dy certifikata të ndara, një për aerodromin dhe një për operatorin e aerodromit.

c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë certifikatën (certifikatat) e përshkruara në pikën b) kur operatori i aerodromit të ketë vërtetuar në mënyrë të pranueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil përpunjen me kërkesat ADR.OR.B.025 dhe ADR.OR.E.005.

d) Certifikata do të përfshijë bazën e certifikimit të aerodromit, manualin e aerodromit, dhe, nëse është e nevojshme, të gjitha kushtet e tjera të operimit ose kufizimet e përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, si dhe çdo Dokument të Pranimit të Devijimit dhe Veprimit (DPDV).

e) Certifikata do të lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Privilegjet e aktiviteteve që operatori i aerodromit është i autorizuar për të kryer do të specifikohen në kushtet e certifikatës që i bashkëngjiten asaj.

f) Kur përgjegjësitë i janë atribuuar (caktuar) organizatave të tjera kompetente, ato duhet të identifikohen dhe të listohen qartë.

g) Gjetjeve, përveç atyre të nivelit 1 dhe që nuk kanë qenë mbyllur para datës së certifikimit, duhet t'u bëhet vlerësimi i sigurisë dhe do të zbuten sipas nevojës, si dhe nga Autoriteti i Aviacionit Civil, do të miratohet një plan veprimi korrigjues për mbylljen e këtyre gjetjeve.

h) Për të mundësuar një operator të aerodromit që të zbatojë ndryshimet pa miratimin paraprak të Autoritetit të Aviacionit Civil në përpunje me ADR.OR.B.040d), Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë një procedurë që përcakton fushëveprimin e ndryshimeve të tilla, duke përshkruar se si do të menaxhohen dhe do të njoftohen këto ndryshime.

ADR.AR.C.040 Ndryshimet- operatori i aerodromit

a) Me marrjen e një aplikimi për një ndryshim, në përpunje me ADR.OR.B.40, që më përpara kërkon miratimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, AAC do të vlerësojë aplikimin dhe, nëse është rasti, njofton operatorin e aerodromit, për:

1. specifikimet e zbatueshme të certifikimit të hartuara nga Agjencia dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të cilat janë të zbatueshme për ndryshimin e propozuar dhe të cilat janë në fuqi në datën e aplikimit, përveç nëse:

(a) aplikanti zgjedh pajtueshmërinë me amendimet që hyjnë më vonë në fuqi; ose

(b) Autoriteti i Aviacionit Civil konstaton se pajtueshmëria me amendime të tilla që hyjnë më vonë në fuqi është e nevojshme;

b) çdo specifikim tjetër të certifikimit të hartuar nga Agjencia dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, që AAC-ja e gjen të lidhur drejtpërdrejt me ndryshimin e propozuar;

c) çdo kusht të veçantë dhe ndryshim të kushteve të veçanta, të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me pikën ADR.AR.C.025, që AAC-ja e shih të nevojshëm; dhe

d) bazën e ndryshuar të certifikimit, në qoftë se është prekur nga ndryshimi i propozuar.

e) Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë ndryshimin kur operatori i aerodromit ka treguar (shfaqur), në mënyrë të pranueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil, pajtueshmëri me kërkesat e ADR.AR.B.040 dhe, nëse zbatohen, me kërkesat ADR.AR.E.005.

f) Nëse ndryshimi i miratuar ndikon në kushtet e certifikatës, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'i ndryshojë ato.

g) Autoriteti i Aviacionit Civil do të miratojë çdo kusht sipas të cilave operatori i aerodromit do të operojë gjatë ndryshimit.

h) Me përjashtim të ndonjë mase detyruese shtesë, kur operatori i aerodromit zbaton ndryshimet që kërkojnë miratimin paraprak pa marrë miratimin nga Autoriteti i Aviacionit Civil sipas përcaktimit në pikën "a" të lartpërmendur, Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë në shqyrtim nevojën për të pezulluar, kufizuar apo revokuar certifikatën.

i) Për ndryshimet që nuk kërkojnë miratim paraprak nga Autoriteti i Aviacionit Civil, AAC-ja do të vlerësojë informacionin e dhënë në njoftimin e dërguar nga operatori i aerodromit në përputhje me ADR.AR.B.040d) për të verifikuar menaxhimin e duhur të tyre dhe do të verifikojë pajtueshmërinë e tyre me specifikimet e certifikimit dhe kërkesat tjera të përshtatshme të zbatueshme për ndryshimin. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, Autoriteti i Aviacionit Civil, do të:

1. njoftojë operatorin e aerodromit në lidhje me mospajtueshmëritë dhe do të kërkojë ndryshime të mëtejshme; dhe

2. në rast të gjetjeve të nivelit 1 ose nivelit 2, do të veprojë në përputhje me pikën ADR.AR.C.055.

ADR.AR.C.050 Deklarata e organizatave përgjegjëse për sigurimin e AMS-së dhe njoftimin e një ndryshimi

a) Pas marrjes së një deklarate nga një organizatë përgjegjëse për sigurimin e AMS që synon të ofrojë këtë shërbim në një aerodrom, ose pasi të marrë një njoftim për ndryshimin në informacionin e përfshirë në deklaratë, AAC do të pranojë marrjen e deklaratës ose njoftimin e ndryshimit dhe do të verifikojë që deklarata ose njoftimi përmban të gjithë informacionin e kërkuar nga aneksi III (Pjesa-ADR.OR).

b) Nëse deklarata ose njoftimi i ndryshimit nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar në pikën ADR. OR.F.005 të aneksit III, ose përmban informacion që nuk është në përputhje me kërkesat e zbatueshme, AAC-ja do të njoftojë organizatën përgjegjëse për sigurimin e AMS-së dhe operatorin e aerodromit kur ofrohet ky shërbim për mos pajtueshmëri dhe të kërkojë informacione të mëtejshme. Nëse gjykohet e nevojshme, autoriteti i Aviacionit Civil do të kryejë një inspektim të organizatës. Nëse konfirmohet mos pajtueshmëria, AAC-ja do të marrë masa siç përcaktohet në pikën ADR.AR.C.055 të këtij aneksi.

c) AAC do të mbajë një regjistër deklaratash dhe të njoftimesh për ndryshimet e organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së nën mbikëqyrjen e tij.

ADR.AR.C.055 Gjetjet, observacionet, veprimet korrigjuese dhe masat detyruese

a) Për mbikëqyrjen e kryer në përputhje me ADR.AR.C.005a), Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë një sistem për të analizuar gjetjet për rëndësinë e tyre në sigurinë në operim (*safety*).

b) Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar do të lëshojë gjetje të nivelit 1 kur është zbuluar ndonjë mospajtueshmëri e ndjeshme me bazën e certifikimit të aerodromit, me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil" dhe rregullave zbatuese të tij, me procedurat dhe manualët e operatorit të aerodromit ose të ofruesit të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve, me kushtet e certifikatës apo vetë certifikatën ose me përmbajtjen e një deklarate e cila ul sigurinë në operim apo rrezikon seriozisht sigurinë në operim.

Niveli 1 i gjetjeve do të përfshijë:

1. dështimin për t'i dhënë Autoritetit të Aviacionit Civil të drejtën e hyrjes në aerodrom dhe në instalimet e operatorit të aerodromit apo të facilitetave të ofruesit të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve siç përcaktohet në ADR.OR.C.015 gjatë orarit normal të punës dhe pas dy kërkesave me shkrim;

2. marrjen ose mbajtjen e vlefshmërisë së një certifikate nëpërmjet falsifikimit të provave dokumentare të paraqitura;

3. dëshmitë e shpërdorimit ose përdorimit mashtrues të certifikatës; dhe

4. mungesën e një menaxheri përgjegjës.

c) Një nivel 2 i gjetjeve do të lëshohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil për çdo mospajtueshmëri të zbuluar me bazën e certifikimit të aerodromit, me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullave zbatuese të tij, me procedurat dhe manualin e operatorit të aerodromit ose të ofruesit të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit, me kushtet e certifikatës ose vetë certifikatën ose me përmbajtjen e një deklarate të cilat mund të ulin ose të rrezikojnë sigurinë në operim.

d) Kur gjatë mbikëqyrjes ose me ndonjë mjet tjetër zbulohet një gjetje, Autoriteti i Aviacionit Civil, pa cenuar ndonjë veprim shtesë të kërkuar nga VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij, do t’ia komunikojë gjetjen operatorit të aerodromit ose ofruesit të shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve në formë të shkruar dhe do të kërkojë veprimet korrigjuese për të adresuar mospajtueshmërinë (mospajtueshmëritë) e identifikuar.

1. Në rastin e gjetjeve të nivelit 1, Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar do të marrë masa të menjëhershme dhe të përshtatshme për të ndaluar ose kufizuar aktivitetet dhe, nëse është rasti, ai do të marrë masa për revokimin e certifikatës ose çregjistrimin e deklaratës, ose do të kufizojë apo pezullojë certifikatën ose deklaratën tërësisht ose pjesërisht, në varësi të masës së gjetjes, derisa të jetë ndërmarrë veprimi korrigjues i suksesshëm nga operatori i aerodromit ose nga ofruesi i shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit.

2. Në rastin e gjetjeve të nivelit 2, Autoriteti i Aviacionit Civil, do të:

a) japë për operatorin e aerodromit ose ofruesin e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve një periudhë për zbatimin e masave korrigjuese të përfshira në një plan veprimi të përshtatshëm për natyrën e gjetjeve; dhe

b) vlerësojë masat korrigjuese dhe planin e zbatimit të propozuar nga operatori i aerodromit ose ofruesi i shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit dhe, nëse vlerësimi konstaton se ato janë të mjaftueshme për të përballuar mospajtueshmërinë, ai do t’i pranojë ato.

3. Kur operatori i aerodromit ose ofruesi i shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit nuk arrin të paraqesë një plan veprimi korrigjues të pranueshëm, apo për të kryer veprime korrigjuese brenda periudhës kohore të pranuar ose të shtyrë nga Autoriteti i Aviacionit Civil, gjetja do të ngrihet në një gjetje të nivelit 1, dhe veprimet do ndërmerren siç parashikohet në pikën d/1 të lartpërmendur.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil do të regjistrojë të gjitha gjetjet që ai ka ngritur dhe, nëse është rasti, masat detyruese që ai ka aplikuar, si dhe të gjitha veprimet korrigjuese dhe datën e mbylljes së veprimit për qëllime të gjetjeve.

e) Për ato raste që nuk kërkojnë nivelin 1 ose nivelin 2 të gjetjeve, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të lëshojë observacion.

f) Çdo zbulim i lëshuar në lidhje me një organizatë përgjegjëse për sigurimin e AMS-ës ose çdo vëzhgim i kryer nga organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-ës do të njoftohet nga AAC si Autoriteti Kompetent për operatorin e aerodromit ku ofrohet ky shërbim.

ANEKSI III
KËRKESAT E ORGANIZATËS (PJESA ADR.OR)
NËNPJESA A – KËRKESA TË PËRGJITHSHME (ADR.OR.A)

ADR.OR.A.005 Fushëveprimi

Ky aneks përcakton kërkesat që duhet të ndiqen nga:

a) një operator aerodromi që i nënshtrohet VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” në lidhje me certifikimin e tij, menaxhimin, manualët dhe përgjegjësitë e tjera; dhe

b) një ofrues i shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve.

ADR.OR.A.010 Autoriteti Kompetent

Për qëllim të kësaj Pjese, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) është autoriteti kompetent.

ADR.OR.A.015 Mjetet e pajtueshmërisë

a) Një operator aerodromi ose një ofrues i shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve mund të përdorë mjete alternative të pajtueshmërisë kundrejt atyre të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil për të vendosur pajtueshmërinë me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij.

b) Kur një operator aerodromi ose një ofrues i shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve dëshiron të përdorë një mjet alternativ të pajtueshmërisë të ndryshëm nga Mjetet e Pranueshme të Pajtueshmërisë (MPP) të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil për të garantuar pajtueshmërinë me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar dhe rregullat zbatuese të tij, përpara zbatimit të tij, ai do t’i japë Autoritetit të Aviacionit Civil një përkthim të plotë të mjeteve alternative të pajtueshmërisë. Përkthimi duhet të përfshijë çdo rishikim të manualeve ose procedurave që mund të jenë të përshtatshme, si dhe një vlerësim që tregon (vërteton) se rregullat zbatuese janë përmbushur.

c) Operatori i aerodromit ose ofruesi i shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve mund të zbatojë këto mjete alternative të pajtueshmërisë me kusht që ato të jenë miratuar paraprakisht nga Autoriteti i Aviacionit Civil dhe pas marrjes së njoftimit, siç përkthuhet në ADR.AR.A.015d).

d) Kur shërbimet e menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve nuk ofrohen nga vetë operatori i aerodromit, përdorimi i mjeteve alternative të pajtueshmërisë nga ana e ofruesve të shërbimeve të tilla, në përputhje me pikat “a” dhe “b” të lartpërmendura, do të kërkojë gjithashtu një miratim paraprak nga operator i aerodromit ku ofrohen shërbime të tilla.

NËNPJESA B – CERTIFIKIMI- AERODOMET DHE OPERATORËT E AERODROMIT (ADR.OR.B)

ADR.OR.B.005 Detyrimet e certifikimit të aerodromeve dhe operatorëve të aerodromit

Para fillimit të operimit të një aerodromi ose kur është revokuar një përjashtim në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje, operator i aerodromit duhet të marrë certifikatën e zbatueshme të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

ADR.OR.B.015 Aplikimi për një certifikatë

a) Aplikimi për një certifikatë duhet të bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Aplikuesi duhet t’i japë Autoritetit të Aviacionit Civil sa vijon:

1. emrin e tij zyrtar dhe emrin e biznesit, adresën, dhe adresën e tij postare;
2. informata dhe të dhëna në lidhje me:

i) vendndodhjen e aerodromit;

ii) llojin e operimeve në aerodrom dhe hapësirën ajrore përkatëse; dhe

iii) projektin dhe instalimet e aerodromit, në përputhje me specifikimet e zbatueshme të certifikimit të hartuara nga Agjencia dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

3. çdo devijim të propozuar nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit të hartuara nga Agjencia dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

4. dokumentacionin, që vërteton se si ai do të përmbushë kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij. Ky dokumentacion do të përfshijë një procedurë, që gjendet në manualin e aerodromit, e cila përshkruan se si do të menaxhohen ndryshimet që nuk kërkojnë miratimin paraprak të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe se si do të njoftohen ato te ky i fundit; ndryshimet e mëvonshme të kësaj procedure do të kërkojnë miratim paraprak nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

5. dëshmitë e mjaftueshmërisë së burimeve për të operuar aerodromin në përputhje me kërkesat e zbatueshme;

6. provat e dokumentuara që tregojnë marrëdhënien e aplikantit me pronarin e aerodromit dhe/ose pronarin e tokës;

7. emrin dhe informatat përkatëse në lidhje me menaxherin përgjegjës dhe të personave të tjerë të emëruar sipas kërkesave të ADR.OR.D.015; dhe

8. një kopje të manualit të aerodromit të kërkuar nga ADR.OR.E.005.

c) Nëse është e pranueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil shqip, informacionet në pikat 7. dhe 8. mund të vihen në dispozicion në një fazë të mëvonshme, të përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, por gjithnjë përpara lëshimit të certifikatës.

ADR.OR.B.025 Demonstrimi (vërtetimi) i pajtueshmërisë

a) Operatori i aerodromit, do të:

1. kryejë dhe dokumentojë të gjitha veprimet, inspektimet, provat, vlerësimet e sigurisë në operim ose ushtrimet e nevojshme, si dhe do të vërtetojë tek Autoriteti i Aviacionit Civil:

i) pajtueshmërinë me bazën e njoftuar të certifikimit, me specifikimet e certifikimit të zbatueshme kundrejt një ndryshimi, me çdo direktivë të sigurisë në operim (*safety*), sipas rastit, dhe me kërkesat e zbatueshme të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij;

ii) se aerodromi, kufizimet e pengesave dhe sipërfaqet e tij të mbrojtjes, si dhe zonat e tjera që lidhen me aerodromin, nuk kanë elemente ose karakteristika të cilat e bëjnë atë të pasigurt për operim; dhe

iii) që procedurat e fluturimit të aerodromit dhe ndryshimet e lidhura me të, janë vendosur në përputhje me urdhrin e ministrit për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre.

2. sigurojë tek Autoriteti i Aviacionit Civil mjetet me të cilat është vërtetuar pajtueshmëria; dhe

3. deklarojë tek Autoriteti i Aviacionit Civil përputhjen e tij me pikën a/1 të lartpërmendur.

b) Informacionet përkatëse të projektimit, duke përfshirë vizatimet (skicimet), inspektimet, testimet dhe raportet e tjera të përshtatshme, do të mbahen nga operatori i aerodromit dhe do të vihen në dispozicion të Autoritetit të Aviacionit Civil, në përputhje me dispozitat e ADR.OR.D.035 dhe do të paraqiten me kërkesë të Autoritetit të Aviacionit Civil.

ADR.OR.B.030 Kushtet e certifikatës dhe privilegjet e mbajtësit të certifikatës

Operatori i aerodromit duhet të jetë në përputhje me qëllimin dhe privilegjet e përcaktuara në kushtet e certifikatës, të cilat i bashkëngjiten asaj.

ADR.OR.B.035 Vlefshmëria e vazhdueshme e një certifikate

a) një certifikatë do të mbetet e vlefshme me kusht që:

1. Operatori i aerodromit të qëndrojë në përputhje me kërkesat përkatëse të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, dhe rregullat zbatuese të tij dhe aerodromi të qëndrojë në përputhje me bazën e certifikimit, duke marrë parasysh dispozitat në lidhje me trajtimin e gjetjeve siç specifikohet në ADR.OR.C.020;

2. Autoritetit të Aviacionit Civil t'i jepet e drejta e hyrjes në organizatën e operatorit të aerodromit në përputhje me kërkesat ADR.OR.C.015 për të përcaktuar pajtueshmërinë e vazhdueshme me dispozitat përkatëse të udhëzimit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe rregullat zbatuese të tij;

3. certifikata nuk është dorëzuar ose anuluar.

b) Pas revokimit ose dorëzimit, certifikata duhet t'i kthehet pa vonesë Autoritetit të Aviacionit Civil.

ADR.OR.B.040 Ndryshimet

a) Çdo ndryshim:

1. që ndikon në kushtet e certifikatës, bazën e certifikimit dhe te pajisjet kritike të sigurisë në operim të aerodromit; ose

2. që ndikon në mënyrë të konsiderueshme tek elementet e sistemit të menaxhimit të operatorit të aerodromit siç kërkohet në ADR.OR.D.005b), do të kërkojë miratim paraprak nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil.

b) Për ndryshimet e tjera që kërkojnë miratim paraprak në përputhje me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij, operatori i aerodromit do të aplikojë dhe do të marrë një miratim të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

c) Aplikimi për një ndryshim në përputhje me pikën “a” ose “b” do të dorëzohet para se një ndryshim i tillë të ndodhë, për t'i mundësuar Autoritetit të Aviacionit Civil që të përcaktojë pajtueshmërinë e vazhdueshme me VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij dhe për të ndryshuar, nëse është e nevojshme, certifikatën dhe kushtet që lidhen me certifikatën bashkangjitur asaj.

Ndryshimi do të zbatohet vetëm pas marrjes së miratimit zyrtar nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me ADR.AR.C.040.

Gjatë ndryshimeve, operatori i aerodromit do të operojë sipas kushteve të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

d) Ndryshimet që nuk kërkojnë miratim paraprak do të menaxhohen dhe të njoftohen tek Autoriteti i Aviacionit Civil siç përcaktohet në procedurën e miratuar nga ky i fundit në përputhje me ADR.AR.C.035 (h).

e) Operatori i aerodromit do t'i japë Autoritetit të Aviacionit Civil dokumentacionin përkatës, në përputhje me pikën “f” dhe ADR.OR.E.005.

f) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, siç përcaktohet në ADR.OR.D.005, operatori i aerodromit duke propozuar një ndryshim në aerodrom, në operimin e tij, në organizimin ose sistemin e tij të menaxhimit do të:

1. përcaktojë ndërvarësitë me çdo palë të prekur, do të planifikojë dhe do të kryejë një vlerësim të sigurisë në operim në koordinim me këto organizata;

2. grupojë supozimet dhe masat për zbutjet në mënyrë sistematike me çdo palë të prekur;

3. sigurojë një vlerësim gjithëpërfshirës të ndryshimit duke përfshirë çdo ndërveprim të nevojshëm; dhe

4. garantojë që argumentet e plota dhe të vlefshme, si dhe provat dhe kriteret e sigurisë të jenë përcaktuar dhe dokumentuar për të mbështetur vlerësimin e sigurisë dhe se ndryshimi mbështet përmirësimin e sigurisë, kurdo që në mënyrë të arsyeshme është e realizueshme.

ADR.OR.B.050 Pajtueshmëria e vazhdueshme me specifikimet e certifikimit të miratuara nga Agjencia dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil

Operatori i aerodromit, pas një ndryshimi të specifikimeve të certifikimit të përcaktuara nga ana e Agjencisë dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, do të:

a) kryejë një rishikim për të identifikuar të gjitha specifikimet e certifikimit të cilat janë të aplikueshme për aerodromin; dhe

b) nëse është e përshtatshme, do të fillojë një proces të ndryshimit në përputhje me ADR.OR.B.040 dhe do të zbatohet ndryshimet e nevojshme në aerodrom.

ADR.OR.B.065 Ndërprerja e operimit

Një operator që synon të ndërpresë operimin e një aerodromi do të:

- a) njoftojë Autoritetin e Aviacionit Civil sa më shpejt që të jetë e mundur;
- b) vërë këtë informacion në dispozicion të ofruesit përkatës të Shërbimit Informativ Aeronautik;
- c) dorëzojë certifikatën tek Autoriteti i Aviacionit Civil në datën e ndërprerjes së operimit; dhe
- d) sigurojë se janë marrë masat e duhura për të shmangur përdorimin e paqëllimshëm të aerodromit nga avioni, përveç nëse Autoriteti i Aviacionit Civil e ka miratuar përdorimin e aerodromit për qëllime të tjera.

ADR.OR.B.070 Përfundimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit

Operatori i aerodromit duhet:

- a) të marrë masat e duhura për të siguruar që rreziqet e sigurisë që rezultojnë nga ndërprerja e funksionimit janë vlerësuar dhe zbutur;
- b) të sigurojë informacion mbi masat e përmendura në pikën a) për ofruesin e duhur të shërbimit të informacionit aeronautik.

NËNPJESA C – PËRGJEGJËSITË SHITESË TË OPERATORIT TË AERODROMIT (ADR.OR.C)

ADR.OR.C.005 Përgjegjësitë e operatorit të aerodromit

a) Operatori i aerodromit është përgjegjës për operimin e sigurt dhe mirëmbajtjen e aerodromit, në përputhje me:

1. VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe rregullat zbatuese të tij;
2. kushtet e certifikatës së tij;
3. përmbajtjen e manualit të aerodromit; dhe
4. çdo manual tjetër për pajisjet e aerodromit në dispozicion të aerodromit, sipas rastit.

b) Operatori i aerodromit do të sigurojë drejtpërdrejt, ose koordinojë përmes marrëveshjeve siç kërkohet me subjektet e përgjegjshme që ofrojnë shërbimet e mëposhtme:

1. ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror të përshtatshme për nivelin e trafikut dhe kushteve të operimit në aerodrom; dhe
2. hartimin dhe mirëmbajtjen e procedurave të fluturimit, në përputhje me kërkesat e zbatueshme.

c) Operatori i aerodromit do të koordinohet me Autoritetin e Aviacionit Civil për të garantuar që informacioni përkatës për sigurinë e avionëve është përfshirë në manualin e aerodromit dhe është botuar, aty ku shihet si e përshtatshme. Kjo do të përfshijë:

1. përjashtimet apo devijimet e dhëna nga kërkesat e zbatueshme;
2. dispozitat për të cilat ishte pranuar një nivel ekuivalent i sigurisë nga Autoriteti i Aviacionit Civil si pjesë e bazës të certifikimit; dhe

3. kushtet e veçanta dhe kufizimet në lidhje me përdorimin e aerodromit.

d) Nëse në aerodrom zbulohet një kusht rrezikshmërie, operatori i aerodromit duhet, pa vonesë, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ato pjesë të aerodromit që janë gjetur se komprometojnë sigurinë nuk përdoren nga avionët.

e) Operatori i aerodromit, në mënyrë që të sigurojë operimin e sigurt të avionit në aerodrom, do të ofrojë dhe do të ruajë, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet marrëveshjeve me palë të treta, ndihmesat vizuale, pajisjet meteorologjike, dhe çdo pajisje tjetër, në përputhje me tipin e operimeve që do të kryhen në atë aerodrom.

ADR.OR.C.015 E drejta e hyrjes në aerodrom

Për qëllimin e përcaktimit të pajtueshmërisë me kërkesat përkatëse në VKM nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të tyre, një operator i aerodromit do t’i japë qasje çdo personi të autorizuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në:

a) çdo facilitet (strukturë), dokument, regjistrime, të dhëna, procedura apo çdo material tjetër që lidhet me veprimtarinë e tij, që i nënshtrohet certifikimit ose deklaratës, qoftë ajo e kontraktuar apo jo; dhe

b) kryerjen ose dëshminë e çdo veprimi, inspektimi, testimi, vlerësimi ose ushtrimi të cilat Autoriteti i Aviacionit Civil i konsideron si të nevojshëm.

ADR.OR.C.020 Gjetjet dhe veprimet korrigjuese

Pas marrjes së njoftimit të informacioneve, operatori i aerodromit do të:

a) identifikojë burimin e shkakut të mos pajtueshmërisë;

b) përcaktojë një plan të veprimit korrigjues; dhe

c) demonstrojë (vërtetojë) zbatimin e veprimit korrigjues në mënyrë të pranueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil brenda periudhës së rënë dakord me këtë autoritet, siç përcaktohet në ADR.AR.C.055d).

ADR.OR.C.025 Reagimi i menjëhershëm për një problem të sigurisë në operim – pajtueshmëria me direktivat e sigurisë në operim

Operatori i aerodromit zbaton të gjitha masat e sigurisë në operim, duke përfshirë direktivat e sigurisë në operim, të përcaktuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me ADR.AR.A.030c) dhe ADR.AR.A.040 të aneksit II.

ADR.OR.C.030 Raportimi i ngjarjeve

a) Operatori i aerodromit do t’i raportojë Autoritetit të Aviacionit Civil dhe çdo organizate tjetër të kërkuar nga legjislacioni kombëtar, çdo aksident, incident serioz dhe ngjarje siç përcaktohet në VKM nr. 739, datë 3.12.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, urdhrin e ministrit nr. 123, datë 22.12.2011 ‘Për adoptimin e rregullores për integrimin në një qendër të përbashkët të informacionit rreth ngjarjeve në aviacionin civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara’” dhe urdhrin nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores ‘Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë’”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pa cenuar pikën “a” operatori do të raportojë tek Autoriteti i Aviacionit Civil dhe tek organizata përgjegjëse për projektimin e pajisjeve të aerodromit, çdo mosfunksionim, defekt teknik, tejkalim të kufizimeve teknike, ngjarje apo rrethanë tjetër të parregullt që ka rrezikuar ose mund të rrezikojë sigurinë dhe që nuk ka shkaktuar një aksident ose incident serioz.

c) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022 ‘Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë’ dhe urdhrin e ministrit nr. 123, datë 22.12.2011 “Për adoptimin e rregullores për integrimin në një qendër të përbashkët të informacionit rreth ngjarjeve në aviacionin civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara” raportet e përmendura në pikat “a” dhe “b” do të bëhen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil dhe do të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me gjendjen e njohur për operatorin e aerodromit ose ofruesin e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionit.

d) Raportet do të bëhen nga operatori i aerodromit brenda 72 orëve nga marrja në dijeni për ngjarjen me të cilën ka të bëjë raporti, përveç nëse rrethanat të jashtëzakonshme e parandalojnë këtë.

e) Kur është e nevojshme, operatori i aerodromit do të prodhojë një raport pasues për të siguruar detaje të veprimeve që synon të ndër marrë për të parandaluar ndodhi të ngjashme në të ardhmen, sa më shpejt që këto veprime të jenë identifikuar. Ky raport do të prodhohet në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga AAC-ja.

ADR.OR.C.040 Parandalimi i zjarrit

Operatori i aerodromit duhet të vendosë procedura për të ndaluar:

a) pirjen e duhanit brenda zonës së lëvizjes, zonave të tjera operationale të aerodromit, ose zonave të aerodromit ku është depozituar lënda djegëse (karburanti) apo materiale të tjera të ndezshme;

b) shfaqjen e një zjarri të hapur apo ndërmarrjen e një aktiviteti që do të krijonte një rrezik zjarri brenda:

1. zonave të aerodromit ku është depozituar lënda djegëse(karburanti) apo materialet e tjera të ndezshme;

2. zonave të lëvizjes apo zonave të tjera operative të aerodromit, përveçse kur janë të autorizuar nga operatori i aerodromit.

ADR.OR.C.045 Përdorimi i alkoolit, substancave psikoaktive dhe ilaçeve

a) Operatori i aerodromit do të vendosë procedura për nivelin e konsumit të alkoolit, substancave psikoaktive dhe ilaçeve për:

1. personelin e përfshirë në operationet e shpëtimit dhe fikjes së zjarrit, dhe mirëmbajtjes së aerodromit;

2. personat e pashoqëruar që veprojnë në zonën e lëvizjes apo në zonat e tjera operationale të aerodromit.

b) Këto procedura do të përfshijnë kërkesat që personat e tillë:

1. të mos konsumojnë alkool gjatë periudhës së tyre në detyrë;

2. të mos kryejnë ndonjë detyrë nën ndikimin e:

i) alkoolit, apo çdo substance psikoaktive; ose

ii) çdo ilaçi që mund të ketë një efekt mbi aftësitë e tij/saj në një mënyrë të tillë që të rrezikojë (komprometojë) sigurinë teknike.

NËNPJESA D – MENAXHIMI – OPERATORI AERODROMIT (ADR.OR.D)

ADR.OR.D.005 Sistemi i menaxhimit

a) Operatori i aerodromit do të zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit duke integruar një sistem të menaxhimit të sigurisë në operim (*safety*).

b) Sistemi i menaxhimit do të përfshijë:

1. linjat e përcaktuara qartë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies për të gjithë operatorët e aerodromit, duke përfshirë edhe një përgjegjësi të drejtpërdrejtë për sigurinë në operim nga ana e menaxhmentit të lartë;

2. një përshkrim të filozofive dhe parimeve të përgjithshme të operatorit të aerodromit në lidhje me sigurinë në operim, të referuara si politika të sigurisë në operim, të nënshkruara nga menaxheri përgjegjës;

3. një proces formal që siguron se janë identifikuar rreziqet në operim;

4. një proces formal që siguron analizimin, vlerësimin dhe zbutjen e risqeve të sigurisë në operimet e aerodromit;

5. mjetet për të verifikuar performancën e sigurisë në operim të organizimit të operatorit të aerodromit në lidhje me treguesit e performancës të sigurisë në operim dhe objektivat e performancës së sigurisë në operim të sistemit të menaxhimit të sigurisë në operim, si dhe për të vërtetuar efektivitetin e kontrolleve të rrezikut të sigurisë në operim;

6. një proces formal për të:

i) identifikuar ndryshimet brenda sistemit të menaxhimit të organizimit të operatorit të aerodromit, aerodromit ose operimit të tij të cilat mund të ndikojnë në proceset, procedurat dhe shërbimet e caktuara;

ii) përshkruar marrëveshjet (mënyrat) e garantimit të performancës së sigurisë në operim përpara zbatimit të ndryshimeve; dhe

iii) eliminuar apo modifikuar kontrollet e riskut të sigurisë në operim që nuk nevojiten më, apo që nuk janë më efektive për shkak të ndryshimeve në mjedisin e operacional;

7. disa procese formale për të rishikuar sistemin e menaxhimit të përcaktuar në paragrafin “a”, për të identifikuar shkaqet e performancës jashtë standardeve të sistemit të menaxhimit të sigurisë në operim, për të përcaktuar implikimet (ndërlikimet) e një performace të tillë të rëndomtë (dobët) në operimet, si dhe për eliminimin ose zbutjen e këtyre shkaqeve;

8. një program trajnimi të sigurisë në operim që garanton se personeli i përfshirë në operacionet e shpëtimit dhe fikjes së zjarrit, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të aerodromit është i trajnuar dhe është kompetent për të kryer detyrat e sistemit të menaxhimit të sigurisë në operim;

9. mjetet formale për komunikimin e sigurisë në operim që garantojnë se personeli është plotësisht i vetëdijshëm për sistemin e menaxhimit të sigurisë në operim, se ai jep informacione të rëndësishme të sigurisë në operim dhe se shpjegon pse janë ndërmarrë veprime të veçanta të sigurisë në operim dhe pse janë futur apo ndryshuar procedurat e sigurisë në operim;

10. koordinimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë në operim me planin e reagimit të emergjencës së aerodromit; dhe koordinimin e planit të reagimit të emergjencës së aerodromit me planet e reagimit të emergjencës së atyre organizatave me të cilat ai do të ndërveprojë gjatë ofrimit të shërbimeve të aerodromit; dhe

11. një proces formal për të monitoruar pajtueshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse.

c) Operatori i aerodromit do të dokumentojë të gjitha proceset kyçe të sistemit të menaxhimit.

d) Sistemi i menaxhimit duhet të jetë në përpjesëtim me madhësinë e organizatës dhe aktivitetet e saj, duke marrë parasysh rreziqet dhe risqet shoqëruese që janë të pandashme nga këto aktivitete.

e) Në rast se operatori i aerodromit zotëron edhe një certifikatë për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror, ai do të garantojë që sistemi i menaxhimit i mbulon të gjitha aktivitetet në fushën e certifikatave të tij.

ADR.OR.D.007 Menaxhimi i të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik

a) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit do të implementojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të cilësisë që mbulon aktivitetet e mëposhtme:

1. aktivitetet e të të dhënave aeronautike;

2. aktivitetet e sigurimit të informacionit aeronautik.

b) Operatori i aerodromit, si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, do të krijojë një sistem të menaxhimit të sigurisë për të garantuar sigurinë e të dhënave operationale që merr, ose prodhon, ose ndryshe përdor, në mënyrë që qasja në ato të dhëna operationale të kufizohet vetëm për të autorizuarit

c) Sistemi i menaxhimit të sigurisë së operatorit të aerodromit do të përcaktojë elementet e mëposhtëm:

1. procedurat në lidhje me vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut të sigurisë së të dhënave, monitorimin dhe përmirësimin e sigurisë, rishikimet e sigurisë dhe shpërndarjen e leksioneve;

2. mjetet e krijuara për të zbuluar shkeljet e sigurisë dhe për të paralajmëruar personelin me paralajmërimet e duhura të sigurisë;

3. mjetet për të kontrolluar efektet e shkeljeve të sigurisë dhe për të identifikuar veprimet e rigjenerimit dhe procedurat e zbutjes për të parandaluar përsëritjen.

d) Operatori i aerodromit do të sigurojë ligjshmërinë për informacion të klasifikuar/leje sigurie të personelit të tij në lidhje me sigurinë e të dhënave aeronautike.

e) Operatori i aerodromit do të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur të dhënat e tij aeronautike nga kërcënimet e sigurisë kibernetike.

ADR.OR.D.010 Aktivitetet e kontraktuara

a) Veprimtaritë e kontraktuara përfshijnë të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të operatorit të aerodromit, në përputhje me kushtet e certifikatës që kryhen nga organizata të tjera ose të vete certifikuara për të kryer një aktivitet të tillë, ose nëse nuk janë certifikuar, që punojnë nën miratimin e operatorit të aerodromit. Operatori i aerodromit do të sigurojë që kur kontraktin apo blen ndonjë pjesë të veprimtarisë së tij, shërbimi ose pajisja apo sistemi i kontraktuar apo i blerë është në përputhje me kërkesat e zbatueshme.

b) Kur një operator i aerodromit kontraktton ndonjë pjesë të veprimtarisë së tij me një organizatë që nuk është e certifikuar në përputhje me këtë pjesë për të kryer një veprimtari të tillë, organizata e kontraktuar do të punojë nën miratimin dhe mbikëqyrjen e operatorit të aerodromit. Operatori i aerodromit do të garantojë që Autoritetit të Aviacionit Civil t'i jepet e drejta e hyrjes në organizatën e kontraktuar, për të përcaktuar pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme.

ADR.OR.D.015 Kërkesat për personelin

a) Operatori i aerodromit do të emërojë një menaxher të përgjithshëm, i cili ka autoritetin për të garantuar që të gjitha aktivitetet të mund të financohen dhe të kryhen në përputhje me kërkesat e zbatueshme. Menaxheri i përgjithshëm do të jetë përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e një sistemi efektiv të menaxhimit.

b) Operatori i aerodromit do të emërojë personat përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e fushave të mëposhtme:

1. shërbimet e operimit të aerodromit; dhe
2. mirëmbajtjen e aerodromit.

c) Operatori i aerodromit duhet të emërojë një person ose grup personash përgjegjës për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë në operim.

Këta persona do të veprojnë në mënyrë të pavarur nga menaxherët e tjerë brenda organizatës, do të kenë qasje të drejtpërdrejtë te menaxheri i përgjithshëm dhe te menaxhmenti përkatës për çështjet e sigurisë në operim dhe do të jenë përgjegjës përpara menaxherit të përgjithshëm.

d) Operatori i aerodromit do të ketë personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për detyrat dhe aktivitetet e planifikuara për t'u kryer në përputhje me kërkesat e zbatueshme.

e) Operatori i aerodromit do të caktojë një numër të mjaftueshëm mbikëqyrësish të personelit me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara, duke marrë parasysh strukturën e organizatës dhe numrin e personelit të punësuar.

f) Operatori i aerodromit do të garantojë se personeli i përfshirë në operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e aerodromit është i trajnuar në mënyrën e duhur në përputhje me programin e trajnimit.

ADR.OR.D.017 Programet e trajnimit dhe kontrollit të aftësive

a) Operatori i aerodromit do të krijojë dhe zbatojë një program trajnimi për personelin e përfshirë në operacion, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e aerodromit, për të siguruar aftësitë e tyre të vazhdueshme, dhe se ata janë të vetëdijshëm për rregullat dhe procedurat në lidhje me funksionimin e aerodromit dhe marrëdhëniet e funksionet dhe detyrat e tyre për funksionimin e aerodromit në tërësi.

b) Trajnimi i përmendur në pikën "a", do të:

1. përfshijë trajnimin fillestar, të përsëritur, përditësues dhe i vazhdueshëm
2. të jetë i përshtatshëm për funksionet dhe detyrat për personelin;
3. përfshijë procedurat e zbatueshme operacionale dhe kërkesat e aerodromit, si dhe drejtimin.

c) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që çdo personel tjetër, përfshirë personelin e organizatave të tjera që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom, të lejojnë hyrjen e pashoqëruar në zonën e lëvizjes dhe zonat e tjera operacionale të aerodromit, të jetë i trajnuar dhe i kualifikuar për këtë hyrje të pashoqëruar.

d) Trajnimi i përmendur në pikën c) do të:

1. përfshijë trajnimin fillestar, të përsëritur, përditësues dhe vazhdueshëm;
2. përfshijë procedurat e zbatueshme operacionale dhe kërkesat e aerodromit, si dhe drejtimin

e) Operatori i aerodromit do të sigurojë që personeli i referuar në pikat "a" dhe "c" të ketë përfunduar me sukses trajnimin e nevojshëm fillestar para se të lejohet:

1. të kryejë detyrat e tij pa mbikëqyrje;
2. hyrja e pashoqëruar në zonën e lëvizjes dhe zonat e tjera operacionale të aerodromit.

Trajnimi fillestar do të përfshijë trajnimin teorik dhe praktik të vlerësimit të kohëzgjatjes dhe kompetencës adekuate të personelit pas ofrimit të trajnimit.

f) Në mënyrë që të vazhdojë të kryejë detyrat e tij të pambikëqyrura dhe të lejohet hyrja e pashoqëruar në zonën e lëvizjes dhe zonat e tjera operationale të aerodromit dhe përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë pjesë dhe pjesën-ADR. OPS, operatori i aerodromit do të sigurojë që personeli i referuar në pikat “a” dhe “c” të jenë trajnuar mbi rregullat dhe procedurat përkatëse për funksionimin e aerodromit duke plotësuar me sukses:

1. trajnim përsëritës, në intervale që nuk i kalojnë 24 muaj nga përfundimi i trajnimit fillestar. Nëse trajnimi përsëritës është ndërmarrë brenda 3 muajve të fundit kalendarikë të intervalit, periudha e re e intervalit do të llogaritet nga data e skadimit të intervalit origjinal;

2. trajnim përditësues, para kryerjes së detyrave të tij të pambikëqyrura ose lejohet hyrja e pashoqëruar në zonën e lëvizjes ose në një zonë tjetër operationale të aerodromit, kur ai mungon në detyrat e tij për një periudhë jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 12 muaj rresht. Në rast të mungesës mbi 12 muaj rresht, ky personel do t'i nënshtrohet trajnimit fillestar në përputhje me pikën “c”;

3. trajnimi i vazhdueshëm për shkak të ndryshimeve në mjedisin e tij të funksionimit ose detyrave të caktuara, sipas nevojës.

g) Operatori i aerodromit do të krijojë dhe zbatojë një program kontrolli të aftësive për personelin e përmendur në pikën “a” dhe të sigurojë për personelin e përmendur në pikën “c” që kanë demonstruar aftësitë e tyre në kryerjen e detyrave, në përputhje me aftësitë e kontrollit të programit, në mënyrë që të sigurohen:

1. kompetenca të vazhdueshme
2. se ata janë të vetëdijshëm për rregullat dhe procedurat që lidhen me funksionet dhe detyrat e tyre.

Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë pjesë dhe pjesën-ADR.OPS, operatori i aerodromit do të sigurojë që personat e përmendur në pikat “a” dhe “c” t'i nënshtrohen kontrolleve të aftësisë në intervale që nuk i kalojnë 24 muaj nga përfundimi i trajnimit të tyre fillestar.

h) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë, që:

1. Përdoren instruktorë të kualifikuar dhe me përvojë për sigurimin e trajnimit dhe vlerësues për vlerësimet dhe kontrollet e aftësive;

2. Mjetet dhe pajisjet e përshtatshme të përdoren për sigurimin e trajnimit dhe, kur është e zbatueshme, për kryerjen e kontrolleve të aftësisë.

i) Operatori i aerodromit do të vendosë dhe zbatojë procedurat për zbatimin e programeve të trajnimit dhe kontrollit të aftësive dhe do të:

1. mbajë shënime të përshtatshme kualifikimi, trajnimi dhe kontrolli të aftësive për të demonstruar pajtueshmërinë me këtë kërkesë;

2. sipas kërkesës, të vendosë të dhënat në dispozicion të personelit në fjalë;

3. nëse një person është i punësuar nga një punëdhënës tjetër, me kërkesë, të vendos të dhënat për atë person në dispozicion të atij punëdhënësi të ri.

ADR.OR.D.020 Kërkesat për facilitetet (strukturat)

a) Operatori i aerodromit do të garantojë se facilitetet (strukturat) e duhura janë vënë në dispozicion të personelit të tij ose personelit të punësuar nga palët me të cilat ai ka kontraktuar për sigurimin e shërbimeve operationale dhe të mirëmbajtjes së aerodromit.

b) Operatori i aerodromit do të përcaktojë zonat e duhura të aerodromit që do të përdoren për magazinimin e mallrave të rrezikshme të transportuara përmes aerodromit, në përputhje me udhëzimet teknike.

ADR.OR.D.025 Koordinimi me organizata të tjera

Operatori i aerodromit do të:

a) garantojë se sistemi i menaxhimit të aerodromit adreson koordinimin dhe ndërveprimin me procedurat në operim të organizatave të tjera që operojnë apo ofrojnë shërbime në aerodrom; dhe

b) garantojë se këto organizata kanë në fuqi procedura mbi sigurinë në operim me qëllim përmbushjen e kërkesave të zbatueshme të udhëzimit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, dhe rregullave zbatuese të tij, si dhe kërkesave të përcaktuara në manualin e aerodromit.

ADR.OR.D.027 Programet e sigurisë në operim

Operatori i aerodromit do të:

a) krijojë, udhëheqë dhe zbatojë programe për të nxitur sigurinë në operim dhe shkëmbimin e informacionit përkatës të sigurisë në operim; dhe

b) inkurajojë (nxisë) organizatat që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom që të përfshihen në programe të tilla.

ADR.OR.D.030 Sistemi i raportimit të sigurisë në operim

a) Operatori i aerodromit do të vendosë dhe do të zbatojë një sistem të raportimit të sigurisë në operim për të gjithë personelin dhe organizatat që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom, për të promovuar sigurinë në operim në aerodrom, si dhe për përdorimin e sigurt të aerodromit.

b) Operatori i aerodromit, në përputhje me ADR.OR.D.005 b/3, do të:

1. kërkojë që personeli dhe organizatat e përmendura në pikën “a” të përdorin sistemin e raportimit të sigurisë në operim për raportimin e detyrueshëm të çdo aksidenti, incidenti të rëndë dhe ngjarjeje; dhe

2. sigurojë që sistemi i raportimit të sigurisë në operim të mund të përdoret për raportimin vullnetar të ndonjë defekti, avarie dhe rreziku të sigurisë në operim, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë në operim.

c) Sistemi i raportimit të sigurisë në operim do të mbrojë identitetin e raportuesit, do të inkurajojë (nxisë) raportimin vullnetar dhe do të përfshijë mundësinë që raportet të mund të paraqiten në mënyrë anonime.

d) Operatori i aerodromit, do të:

1. regjistrojë të gjitha raportet e paraqitura;

2. analizojë dhe vlerësojë raportet, sipas rastit, me qëllim korrigjimin e mangësive të sigurisë në operim dhe identifikimin e tendencave (ecurisë);

3. garantojë se të gjitha organizatat që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom, të cilat janë të lidhura me shqetësimin e sigurisë në operim, të marrin pjesë në analizën e raporteve të tilla dhe që të gjitha masat korrigjuese dhe/ose masat parandaluese të identifikuar të jenë zbatuar;

4. kryejë hetime të raporteve sipas rastit; dhe

5. të shmangë ngarkimin e fajit në përputhje me parimet e “*just culture*”.

ADR.OR.D.035 Mbajtja e të dhënave

a) Operatori i aerodromit do të krijojë një sistem të përshtatshëm të mbajtjes së të dhënave, duke mbuluar të gjitha aktivitetet e tij të ndërmarra sipas udhëzimit nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar dhe rregullave zbatuese të tij.

b) Format i të dhënave do të specifikohet në manualin e aerodromit.

c) Të dhënat e regjistruara do të ruhen në një mënyrë që siguron mbrojtje nga dëmet, ndryshimet dhe vjedhja.

d) Të dhënat e regjistruara do të mbahen për një minimum prej pesë vjetësh, përveç të dhënave të mëposhtme që do të mbahen si në vijim:

1. baza e certifikimit e aerodromit, mjetet alternative të pajtueshmërisë në përdorim dhe certifikata aktuale e aerodromit ose operatorit të aerodromit, për gjithë jetëgjatësinë e certifikatës;

2. marrëveshjet me organizata të tjera, për aq kohë sa marrëveshje të tilla janë në fuqi;

3. manualet e pajisjeve të aerodromit ose sistemeve të angazhuar në aerodrom, për aq kohë sa ato përdoren në aerodrom;

4. raportet e vlerësimit të sigurisë në operim për gjithë kohëzgjatjet e sistemit/ procedurës/ aktivitetit;

5. trajnimi i personelit, kualifikimet dhe të dhënat mjekësore, si dhe kontrollet e aftësisë së tyre, sipas rasteve, për të paktën katër vjet pas përfundimit të punësimit (marrëdhëniet e tyre të punës) të tyre, ose deri sa fusha e punësimit të tyre të jetë objekt auditimi (verifikimi) nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil; dhe

6. Versioni aktual i regjistrit të rreziqeve;

7. Autorizimet e drejtimit të automjetit dhe, nëse është e përshtatshme, certifikatat e aftësive të gjuhës, për të paktën katër vjet pas përfundimit të punësimit të një personi, ose revokimin ose anulimin e një Autorizim drejtimi, ose derisa kjo fushë e veprimtarisë të jetë audituar nga autoritetet kompetente;

8. Autorizimet e automjeteve dhe regjistrat e mirëmbajtjes së automjeteve të operatorit të aerodromit, për të paktën katër vjet pasi një automjet është hequr nga operimi, ose derisa kjo zonë të auditohet nga autoriteti kompetent.

e) Të gjitha të dhënat e regjistruara do t'i nënshtrohen ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

NËNPJESA E – MANUALI I AERODROMIT DHE DOKUMENTACIONI (ADR.OR.E)

ADR.OR.E.005 Manuali i Aerodromit

a) Operatori i aerodromit do të krijojë dhe mirëmbajë një manual të aerodromit.

b) Përmbajtja e manualit të aerodromit do të pasqyrojë bazën e certifikimit dhe kërkesat e përcaktuara në këtë pjesë dhe pjesën-ADR.OPS, siç është e zbatueshme (sipas rastit) dhe nuk do të shkelë kushtet e certifikatës. Manuali i aerodromit do të përmbajë ose referojë të gjitha informacionet e nevojshme për përdorimin e sigurt, operimin dhe mirëmbajtjen e aerodromit, pajisjeve të tij, si dhe kufizimet e pengesave, sipërfaqet mbrojtëse të tij dhe fushate tjera që lidhen me aerodromin.

c) Manuali aerodromit mund të hartohet në pjesë të veçanta.

d) Operatori i aerodromit do të garantojë se i gjithë personeli i aerodromit dhe personeli i gjithë organizatave të tjera përkatëse ka qasje të lehtë në pjesë të manualit të aerodromit që janë të lidhura me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

e) Operatori i aerodromit do të:

1. vërë në dispozicion të Autoritetit të Aviacionit Civil ndryshimet që do të bëjë dhe rishikimet e manualit të aerodromit, për pikat që kërkojnë miratim paraprak në përputhje me ADR.OR.B.040, përpara datës efektive dhe do të garantojë se ato nuk do të hyjnë në fuqi para marrjes së miratimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil; ose

2. vërë në dispozicion të Autoritetit të Aviacionit Civil ndryshimet që do të bëjë dhe rishikimet e manualit të aerodromit përpara datës efektive, nëse ndryshimi i propozuar apo rishikimi i manualit të aerodromit kërkon vetëm një njoftim Autoritetit të Aviacionit Civil në përputhje me ADR.OR.B 0,040d) dhe ADR.OR.B.015b).

f) Pavarësisht pikës “e”, kur ndryshimet apo rishikimet kërkojnë në interes të sigurisë në operim, ato mund të publikohen dhe të zbatohen menjëherë, me kusht që të jetë aplikuar për marrjen e çdo miratimi të kërkuar.

g) Operatori i aerodromit, do të:

1. rishikojë përmbajtjen e manualit të aerodromit, për të garantuar se ai është mbajtur i përditësuar dhe i amenduar kudo që është e nevojshme;

2. përfshijë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e kërkuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil; dhe

3. njoftojë të gjithë personelin e aerodromit dhe organizatat e tjera përkatëse për ndryshimet që lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

h) Operatori i aerodromit do të garantojë se çdo informacion i marrë nga dokumentet e tjera të miratuara dhe çdo ndryshim i tyre, është pasqyruar saktë në manualin e aerodromit. Kjo nuk e pengon operatorin e aerodromit të publikojë të dhëna dhe procedura më të rezervuara në manualin e aerodromit.

i) Operatori i aerodromit do të garantojë, se:

1. manuali i aerodromit është shkruar në një gjuhë të pranueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil; dhe

2. i gjithë personeli është në gjendje të lexojë dhe të kuptojë gjuhën në të cilën janë të shkruar ato pjesë të manualit të aerodromit dhe dokumentet e tjera operative që kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

j) Operatori i aerodromit do të garantojë se manuali i aerodromit:

1. është nënshkruar nga menaxheri i përgjithshëm i aerodromit;

2. është shtypur ose është në format elektronik dhe është i lehtë për t'u rishikuar (lehtësisht i rishikueshëm);

3. ka një sistem për menaxhimin e kontrollit të versionit i cili zbatohet dhe është paraqitur në manualin e aerodromit; dhe

4. zbaton parimet e faktorit njeri (faktorëve njerëzorë) dhe është i organizuar në mënyrë të tillë që lehtëson përgatitjen, përdorimin dhe rishikimin e tij.

k) Operatori i aerodromit do të mbajë të paktën një kopje të plotë dhe aktuale të manualit të aerodromit në aerodrom dhe ta vërë atë në dispozicion për inspektim nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil.

l) Përmbajtja e manualit të aerodromit do të jetë si në vijim:

1. Të përgjithshme;

2. Sistemi i menaxhimit të aerodromit, kërkesat për kualifikimin dhe trajnimin;

3. Karakteristikat e aerodromit;

4. Të dhënat e aerodromit që kërkohet të raportohen në Shërbimin e Informacionit Aeronautik; dhe

5. Të dhënat e procedurave të operimit të aerodromit, pajisjeve të tij dhe masave të sigurisë teknike.

ADR.OR.E.010 Kërkesat për dokumentacionin

a) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë disponueshmërinë e çdo dokumentacioni tjetër të kërkuar si dhe amendimet përkatëse.

b) Operatori i aerodromit do të jetë i aftë për shpërndarjen pa vonesë të udhëzimeve operationale dhe informacioneve të tjera.

NËNPJESA F – SHËRBIMI I MENAXHIMIT TË VENDQËNDRIMIT (ADR.OR.F)

ADR.OR.F.001 Përgjegjësitë e organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së

Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS do të sigurojë shërbimin e menaxhimit të vendqëndrimit në përputhje me:

a) kërkesat e përcaktuara në shtojcën VII të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe në aneksin III (Pjesa-ADR.OR) dhe aneksi IV (Pjesa-ADR.OPS) të kësaj rregulloreje;

b) deklarata e saj;

c) procedurat e operimit të përfshira në manualin e aerodromit;

d) manuali i sistemit të menaxhimit në përputhje me ADR.OR.F.095;

e) çdo manual tjetër që përdoret për sigurimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit.

ADR.OR.F.005 Deklarata e organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së

a) Kur një organizatë përgjegjëse për sigurimin e AMS-së synon të sigurojë udhëzime për avionët siç përcaktohet në pikat a/1 dhe a/2 të pikës ADR.OPS.D.001 si minimum, ajo do të paraqesë një deklaratë tek AAC-ja, të paktën 2 muaj para datës së fillimit të parashikuar të ofrimit të shërbimit. Deklarata përmban informacionin e mëposhtëm:

1. emrin e organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së;

2. të dhënat e kontaktit të organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së;

3. emrin dhe të dhënat e kontaktit të menaxherit të përgjegjshëm
4. emrin/at e aerodromit/ve ku do të ofrohet shërbimi;
5. kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, një listë të aerodromeve të vendosura në Shtetet e tjera Anëtare ku ofrohet shërbimi;
6. data e fillimit të synuar të sigurimit të shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit;
7. një deklaratë që konfirmon se ka vendosur marrëveshje zyrtare me operatorin e aerodromit dhe ofruesin e shërbimit të trafikut ajror në aerodrom ku synon të sigurojë shërbimin e menaxhimit të vendqëndrimit;
8. një deklaratë që konfirmon që organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së ka zhvilluar një politikë sigurie dhe do ta zbatojë atë politikë gjatë ofrimit të shërbimit të mbuluar nga deklarata, në përputhje me pikën ADR.OR.F.045 b/2;
9. një deklaratë që konfirmon se organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së është në përputhje dhe, gjatë ofrimit të shërbimit të mbuluar nga deklarata, do të vazhdojë të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të shtojcës VII të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aneksit III (Pjesa-ADR.OR) dhe aneksi IV (Pjesa- ADR.OPS) të kësaj rregulloreje;
- b) Me përjashtim nga pika a), kur operatori i certifikuar i aerodromit ose ofruesi i miratuar i shërbimeve të trafikut ajror synon të ofrojë shërbimin e menaxhimit të vendqëndrimit, ai do të:
 1. njoftojë AAC si Autoriteti i tij Kompetent;
 2. rishikojë politikën e tij të sigurisë për të përfshirë sigurimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit;
 3. paraqesë në AAC programin e trajnimit të personelit që synohet të përdoret për ofrimin e shërbimit.

ADR.OR.F.010 Vlefshmëria e vazhdueshme e deklaratës

Një deklaratë e bërë nga një organizatë përgjegjëse për sigurimin e AMS-së në përputhje me pikën ADR.OR.F.005 do të mbetet e vlefshme në varësi të kushteve të mëposhtme:

- a) organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën VII të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe në aneksin III (Pjesa-ADR.OR) dhe aneksi IV (Pjesa-ADR.OPS) e kësaj rregulloreje, duke marrë parasysh dispozitat në lidhje me trajtimin e informacioneve siç specifikohet në pikën ADR.OR.F.035 të këtij aneksi;
- b) AAC-së i lejohet hyrja në organizatën përgjegjëse për sigurimin e AMS-së në përputhje me pikën ADR.OR.F.030 të këtij aneksi për të përcaktuar pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e përcaktuara në shtojcën VII të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020 “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe në aneksin III (Pjesa-ADR.OR) dhe aneksi IV (Pjesa-ADR.OPS) e kësaj rregulloreje;
- c) deklarata nuk është tërhequr nga organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së ose është njoftuar nga AAC për të ndaluar disa ose të gjitha shërbimet e mbuluara nga deklarata.

ADR.OR.F.015 Fillimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit

Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të fillojë sigurimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit në një aerodrom, kur:

- a) deklarata është marrë nga AAC;
- b) ka vendosur marrëveshje zyrtare me operatorin e certifikuar të aerodromit dhe ofruesin e miratuar të shërbimit të trafikut ajror në aerodromin ku shërbimi do të ofrohet në përputhje me pikat ADR.OR.F.085 dhe ADR. përkatësisht OR.F.090;
- c) siguron prova se personeli i saj ka përfunduar trajnimin e kërkuar fillestar dhe për njësi.

ADR.OR.F.020 Përfundimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit

Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së që synon të ndërpresë përfundimisht ofrimin e shërbimit në një aerodrom do të:

a) njoftojë operatorin e aerodromit dhe AAC, sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të bëjë të mundur marrjen e masave të duhura për vazhdimin e sigurt të shërbimit;

b) paraqesë në AAC një deklaratë të ndryshuar ose të kërkojë çregjistrimin e deklaratës, me datën e përfundimit të ofrimit të shërbimit.

ADR.OR.F.025 Ndryshimet

a) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të koordinojë me operatorin e aerodromit çdo ndryshim në informacionin që përmbahet në deklaratën e specifikuar në pikën ADR.OR.F.005 a) dhe në programin e trajnimit ose manualin e sistemit të menaxhimit, referuar përkatësisht në pikën ADR.OR.F.005 “b” dhe pika ADR.OR.F.095.

b) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të njoftojë, pa vonesë të panevojshme, AAC-në për çdo ndryshim të specifikuar në pikën “a” dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë një deklaratë të ndryshuar.

c) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do t’i sigurojë AAC-së dokumentacionin përkatës në përputhje me pikën “d”.

d) Si pjesë e sistemit të saj të menaxhimit të referuar në pikën ADR.OR.F.045, organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së që propozon një ndryshim në organizatën e saj, sistemin e saj të menaxhimit ose programin e saj të trajnimit:

1. përcakton ndërvarësinë me çdo palë të prekur dhe planifikon dhe kryen një vlerësim të sigurisë në koordinim me këto organizata;

2. rregullon supozimet dhe lehtësirat me çdo palë të prekur në mënyrë sistematike;

3. të sigurojë një vlerësim gjithëpërfshirës ndryshimi, duke përfshirë çdo ndërveprim të nevojshëm;

4. të sigurojë që argumentet e plota dhe të vlefshme, provat dhe kriteret e sigurisë janë krijuar dhe dokumentuar për të mbështetur vlerësimin e sigurisë, dhe se ndryshimi mbështet përmirësimin e sigurisë kurdoherë që është e mundur.

ADR.OR.F.030 Hyrja

Për qëllimin e përcaktimit nëse një organizatë përgjegjëse për sigurimin e AMS-së po vepron në përputhje me deklaratën e saj, organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të sigurojë që çdo person i autorizuar ligjërisht nga AAC, në çdo kohë:

a) i lejohej hyrja në çdo strukturë, dokument, regjistër, të dhëna, procedurë ose çdo material tjetër në lidhje me veprimtarinë e tij;

b) lejohej të kryejë ose të dëshmojë çdo veprim, inspektim, provë, vlerësim ose ushtrim që Autoriteti i Aviacionit Civil e sheh të nevojshme.

ADR.OR.F.035 Informacionet/gjetjet dhe veprimet korrigjuese

a) Pasi AAC t’i ketë komunikuar një informacion/gjetje organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS në përputhje me pikën ADR.AR.C.055 të aneksit II, organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të ndërmarrë hapat e mëposhtëm brenda periudhës kohore të përcaktuar nga AAC:

1. të identifikojë shkaku kryesor të mosrespektimit;

2. të përcaktojë një plan veprimi korrigjues;

3. të demonstrojë zbatimin e veprimit korrigjues për kënaqësinë e AAC brenda periudhës kohore të rënë dakord me atë autoritet në përputhje me pikën ADR.AR.C.055d) të aneksit II.

b) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të informojë operatorin e aerodromit për veprimet e detajuara në pikën “a” dhe, kur është e përshtatshme, të koordinojë këto veprimet me operatorin e aerodromit.

ADR.OR.F.040 Reagim i menjëhershëm ndaj një problemi sigurie – pajtueshmëria me direktivat e sigurisë

Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së duhet të:

a) zbatojë çdo masë sigurie, përfshirë direktivat e sigurisë, të marra nga Autoriteti i Aviacionit Civil në përputhje me pikat ADR.AR.A.030 “c” dhe ADR.AR.A.040 të aneksit II;

b) kur zbaton masat e përmendura në pikën a), koordinon me operatorin e aerodromit dhe ofruesin e shërbimit të trafikut ajror, kur është e nevojshme.

ADR.OR.F.045 Sistemi i menaxhimit

a) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së, operatori i aerodromit ose ofruesi i shërbimit të trafikut ajror, kur ky i fundit siguron pjesërisht ose ekskluzivisht shërbime të menaxhimit të vendqëndrimit, do të zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi që integron një sistem të menaxhimit të sigurisë që gjithashtu mbulon ato aktivitete.

b) Sistemi i menaxhimit do të përfshijë:

1. linjat e përcaktuara qartë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies në të gjithë organizatën, duke përfshirë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për sigurinë nga ana e menaxhimit të nivelit të lartë;

2. një përshkrim të filozofive dhe parimeve të përgjithshme të organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së në lidhje me sigurinë, referuar si politika e sigurisë, e nënshkruar nga menaxheri i përgjegjës;

3. një proces zyrtar që siguron që rreziqet në operacione të identifikohen;

4. një proces zyrtar që siguron analizën, vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve të sigurisë në ofrimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit;

5. mjetet për të verifikuar performancën e sigurisë së organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së në lidhje me treguesit dhe objektivat e performancës së sigurisë së sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe për të vërtetuar efektivitetin e kontroleve të rrezikut të sigurisë;

6. një proces zyrtar për të:

i. identifikuar ndryshimet brenda organizatës, sistemit të menaxhimit të saj, ose ofrimit të shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit që mund të ndikojë në proceset, procedurat dhe shërbimet e vendosura;

ii. përshkruar marrëveshjet për të siguruar performancën e sigurisë para se të zbatohen ndryshimet;

iii. eliminuar ose modifikuar kontrollet e rrezikut të sigurisë që nuk janë më të nevojshme ose efektive për shkak të ndryshimeve në mjedisin operativ;

7. një proces zyrtar për të rishikuar sistemin e menaxhimit të përmendur në pikën “a”, për të identifikuar shkakun/qet e performancës nën standard të sistemit të menaxhimit të sigurisë, për të përcaktuar implikimet e kësaj performancë nën standard në operacione dhe për të eliminuar ose zbutur shkaqe/t të tilla;

8. një program trajnimi për sigurinë që garanton se personeli i përfshirë në sigurimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit të jetë i trajnuar dhe kompetent për të kryer detyrat e menaxhimit të sigurisë;

9. mjete formale për komunikim të sigurt që siguron se personeli është plotësisht i vetëdijshëm për sistemin e menaxhimit të sigurisë, përcjell informacione kritike për sigurinë dhe shpjegon pse ndërmerren veprime të veçanta të sigurisë dhe pse futen ose ndryshohen procedurat e sigurisë;

10. një proces zyrtar për të monitoruar pajtueshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse.

c) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të dokumentojë të gjitha proceset kryesore të sistemit të menaxhimit në një manual.

ADR.OR.F.050 Raportimi i keqfunksionimeve të sistemeve të përdorura për sigurimin e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit

Pa cenuar urdhrin nr. 89, datë 5.5.2022 “Për miratimin e rregullores ‘Për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë’”, organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do t’i raportojë Autoritetit AAC si Autoriteti Kompetent i shtetit ku ndodhet aerodromi, operatorit të aerodromit dhe organizatës përgjegjëse për hartimin e pajisjeve të çdo aerodromi të përdorura për sigurimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit çdo mosfunksionim, defekt teknik, tejkalim të kufizimeve teknike, ndodhi ose rrethana të tjera të parregullta që kanë ose mund të kenë rrezikuar sigurinë dhe që nuk ka rezultuar në aksident ose incident serioz.

ADR.OR.F.055 Sistemi i raportimit të sigurisë

a) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të krijojë dhe zbatojë një sistem të raportimit të sigurisë për personelin e saj.

b) Si pjesë e procesit të përmendur në pikën ADR.OR.F.045 b)(3), organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të sigurojë që:

1. personeli i saj përdor sistemin e raportimit të sigurisë për raportimin e detyrueshëm të çdo aksidenti, incident serioz dhe ndodhie;

2. sistemi i raportimit të sigurisë mund të përdoret për raportimin vullnetar të çdo defekti, problemi dhe rreziku sigurie që mund të ndikojë në siguri.

c) Sistemi i raportimit të sigurisë duhet të mbrojë identitetin e reporterit, të inkurajojë raportimin vullnetar dhe të përfshijë mundësinë që raportet të paraqiten në mënyrë anonime.

d) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të:

1. regjistrojë të gjitha raportet e paraqitura;

2. transmetojë raportet tek operatori i aerodromit dhe, nëse është e rëndësishme, tek ofruesi i shërbimit të trafikut ajror;

3. në bashkëpunim me operatorin e aerodromit ose ofruesin e shërbimit të trafikut ajror, ose të dy, do të analizojë dhe vlerësojë raportet, me qëllim adresimin e mangësive të sigurisë dhe identifikimin e trendeve;

4. marrë pjesë në hetimin e raporteve të kryera nga operatori i aerodromit, sipas rastit;

5. do të distancohet nga lënia e fajit në përputhje me parimet e “kulturës së drejtë”.

ADR.OR.F.060 Programet e sigurisë

Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të marrë pjesë në programet e sigurisë të vendosura nga operatori i aerodromit.

ADR.OR.F.065 Kërkesat e personelit

a) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të:

1. caktojë një menaxher të përgjegjshëm, i cili ka autoritetin të sigurojë që të gjitha aktivitetet mund të financohen dhe të kryhen në përputhje me kërkesat e zbatueshme. Menaxheri i përgjegjshëm do të jetë përgjegjës për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi efektiv të menaxhimit;

2. të emërojë një person përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve operationale në lidhje me menaxhimin e vendqëndrimit;

3. të emërojë një person përgjegjës për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e përditshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë. Ky person do të veprojë në mënyrë të pavarur nga menaxherët e tjerë brenda organizatës, do të ketë qasje të drejtpërdrejtë te menaxheri i përgjegjshëm dhe te menaxhimi i duhur për çështjet e sigurisë dhe do të jetë përgjegjës para menaxherit përgjegjës;

4. të ketë personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për detyrat dhe aktivitetet e planifikuara që do të kryhen në përputhje me kërkesat në fuqi;

5. caktojë një numër të mjaftueshëm të mbikëqyrësve të personelit për detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara, duke marrë parasysh strukturën e organizatës dhe numrin e personelit të punësuar;

6. të sigurojë që personeli i përfshirë në sigurimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit është trajnuar në mënyrë adekuate në përputhje me programin e trajnimit.

b) Në rast se operatori i aerodromit ose ofruesi i shërbimit të trafikut ajror sigurojnë pjesërisht ose ekskluzivisht shërbimin e menaxhimit të vendqëndrimit, ata duhet të sigurojnë që kërkesat e pikës a) të përfshihen në caktimin e përgjegjësive të tyre të caktuara brenda sistemeve të tyre të menaxhimit.

ADR.OR.F.075 Konsumimi i alkoolit, substancave psikoaktive dhe ilaçeve

Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të zbatojë procedurat e vendosura nga operatori i aerodromit në përputhje me pikën ADR.OR.C.045 në lidhje me konsumin e alkoolit, substancave psikoaktive dhe ilaçeve nga personeli i saj i përfshirë në ofrimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit të aeroportit.

ADR.OR.F.080 Mbajtja e të dhënave, regjistrave

Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të krijojë një sistem adekuat të mbajtjes së të dhënave që mbulon të gjitha aktivitetet e saj të ndërmarra në përputhje me VKM Nr. 1095, datë 24.12.2020 Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj.

- a) Format i të dhënave duhet të specifikohet në manualin e sistemit të menaxhimit.
- b) Të dhënat do të ruhen në mënyrë që siguron mbrojtje nga dëmtimi, ndryshimi dhe vjedhja.
- c) Të dhënat duhet të mbahen minimumi 5 vite, përveç se kur:
 1. deklarata aktuale do të mbahet për periudhën e jetëgjatësisë/vlefshmërisë së deklaratës;
 2. marrëveshjet e shkruara me organizata të tjera do të mbahen për aq kohë sa këto marrëveshje janë në fuqi;
 3. Raportet e vlerësimit të sigurisë do të mbahen për periudhën e jetëgjatësisë së sistemit, procedurës ose veprimtarisë;
 4. trajnimi i personelit, kualifikimet, si dhe kontrollet e tyre të aftësisë do të mbahen për të paktën 4 vjet pas përfundimit të punësimit, ose derisa fusha e punësimit të tyre të kontrollohet nga Autoriteti I Aviacionit Civil;
- d) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të krijojë dhe mirëmbajë një regjistër rreziqesh.

ADR.OR.F.085 Marrëveshje zyrtare midis organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së dhe operatorit të aerodromit

- a) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të ketë një marrëveshje zyrtare me operatorin e aerodromit ku ajo synon të ofrojë shërbimin e menaxhimit të vendqëndrimit.
- b) Marrëveshja do të konkludohet para fillimit të ofrimit të shërbimit.
- c) Marrëveshja zyrtare do të përfshijë si minimum sa vijon:
 1. kohëzgjatja e marrëveshjes;
 2. përkufizimi i zonës ku do të ofrohet shërbimi i menaxhimit të vendqëndrimit;
 3. lista e shërbimeve që do të kryhen nga organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së;
 4. metodat e shkëmbimit të informacionit operativ midis operatorit të aerodromit dhe organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së.

ADR.OR.F.090 Marrëveshje zyrtare midis organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së dhe ofruesit të shërbimit të trafikut ajror

- a) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të ketë një marrëveshje zyrtare me ofruesin e shërbimit të trafikut ajror të aerodromit ku ajo synon të ofrojë shërbimin e menaxhimit të vendqëndrimit.
- b) Marrëveshja do të konkludohet para fillimit të ofrimit të shërbimit.
- c) Marrëveshja zyrtare do të përfshijë si minimum sa vijon:
 1. kohëzgjatja e marrëveshjes;
 2. fushëveprimi i shërbimeve që do të ofrohen, përfshirë koordinimin e autorizimeve fillestare, taksitë dhe kthimin e avionëve;
 3. pikat e dorëzimit ndërmjet shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit dhe ofruesit të shërbimit të trafikut ajror;
 4. metodat e shkëmbimit të informacionit operativ midis ofruesit të shërbimit të trafikut ajror dhe organizatës përgjegjëse për sigurimin e AMS-së;
 5. koordinimi i lejeve fillestare, për rrugët lidhëse dhe vonesave, kthimit të avionëve.

ADR.OR.F.095 Manuali i sistemit të menaxhimit

- a) Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së, do të:
 1. krijojë dhe mirëmbajë manualin e sistemit të menaxhimit;
 2. të sigurojë që personeli i saj të ketë qasje të lehtë në manual dhe të bëhet i vetëdijshëm për çdo ndryshim;
 3. Pas konsultimit dhe në koordinim me operatorin e aerodromit, të pajisë AAC-në me ndryshimet dhe rishikimet e parashikuara të manualit para datës së efektshme;

4. rishikojë përmbajtjen e manualit, do të sigurohet që manuali të mbahet i përditësuar dhe të ndryshohet, kur është e nevojshme;

5. përfshijë të gjitha ndryshimet dhe rishikimet në manual siç kërkohet nga AAC;

6. të bëjë organizatat e tjera të interesuara të vetëdijshme për ndryshimet që janë të rëndësishme për detyrat e tyre.

7. të sigurojë që çdo informacion i marrë nga dokumente të tjera të miratuara dhe çdo ndryshim, të pasqyrohet saktë në manual;

8. të sigurojë që manuali është shkruar në gjuhë të pranueshme për AAC-në;

9. të sigurojë që i gjithë personeli të jetë në gjendje të lexojë dhe kuptojë gjuhën në të cilën janë shkruar ato pjesë të manualit dhe dokumenteve të tjera që kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre;

10. të sigurojë që manuali të nënshkruhet nga menaxheri i përgjegjshëm i organizatës;

11. të sigurojë që manuali të jetë shtypur ose është në format elektronik dhe të rishikohet lehtë;

12. të sigurojë që manuali të ketë një sistem për menaxhimin e kontrollit të versionit, i cili zbatohet dhe bëhet i dukshëm në manual;

13. të sigurojë që manuali të vëzhgojë parimet e faktorëve njerëzorë dhe të jetë i organizuar në një mënyrë që lehtëson përgatitjen, përdorimin dhe rishikimin e tij;

14. mbajë të paktën një kopje të plotë dhe aktuale të manualit në aerodromin ku ai ofron shërbimin dhe do ta vendosë në dispozicion për inspektim nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

b) Përmbajtja e manualit duhet të strukturohet si më poshtë:

1. pjesa e përgjithshme;

2. kërkesat e kualifikimit dhe sistemi i menaxhimit të organizatës.

c) Në rast se operatori i aerodromit ose ofruesi i shërbimit të trafikut ajror sigurojnë pjesërisht ose ekskluzivisht shërbimin e menaxhimit të vendqëndrimit, ata duhet të sigurojnë që kërkesat përkatëse në pikën “b” të përfshihen përkatësisht në manualin e aerodromit ose manualin e operacioneve të shërbimit të trafikut ajror.

ADR.OR.F.100 Kërkesat e dokumentimit

Organizata përgjegjëse për sigurimin e AMS-së do të:

a) vëre në dispozicion të personelit të tij operativ pjesë të manualit të aerodromit në lidhje me sigurimin e shërbimit të menaxhimit të vendqëndrimit;

b) vëre në dispozicion çdo dokumentacion tjetër të kërkuar nga AAC dhe ndryshimet përkatëse;

c) do të shpërndajë udhëzimet operationale dhe informacione të tjera pa vonesë.

ANEKSI IV

PJESA KËRKESAT OPERACIONALE – AERODROMET (PJESA-ADR.OPS)²

NËNPJESA A – TË DHËNAT E AERODROMIT (ADR.OPS.A)

ADR.OPS.A.005 Të dhënat e aerodromit

Operatori i aerodromit sipas nevojës (sipas rastit), do të:

a) përcaktojë, dokumentojë dhe do të mbajë të dhënat përkatëse të aerodromit dhe shërbimeve të disponueshme të tij;

b) japë të dhënat përkatëse të aerodromit dhe shërbimeve të disponueshme përdoruesve të aerodromit dhe shërbimeve përkatëse të trafikut ajror, si dhe ofruesve të shërbimeve të informacionit aeronautik.

ADR.OPS.A.010 Kërkesat e cilësisë së të dhënave

Operatori i aerodromit do të ketë marrëveshje zyrtare me organizatat me të cilat shkëmben të dhëna aeronautike ose informacione aeronautike dhe do të sigurojë sa vijon:

² ADR – do të thotë Aerodromet dhe OPS – do të thotë Operimet. Përcaktimi i numrit rendor të kërkesave është bërë i tillë që të jetë në përputhje me numrat rendorë të përcaktuara në Rregulloret përkatëse të BE-së.

